

LEXMARK
LEGAL

KENI NEVOJË PËR KËSHILLA TË EKSPERTËVE PËR
IMIGRACIONIN NË MB? MOS KËRKONI MË TEJ!

EKIPI YNË I AVOKATËVE ME PËRVOJË TË IMIGRACIONIT ËSHTË I
SPECIALIZUAR NË:

- APLIKIMET PËR VIZË
- VENDBANIM TË PËRHERSHËM
- SHTETËSIA
- RASTET E AZILIT
- APELET PËR DËBIM

NE JEMI KËTU PËR T'JU UDHËHEQUR NË ÇDO HAP
TË RRUGËS. SUKSESI JUAJ NË EMIGRACION
ËSHTË MISIONI YNË!

KONTAKTONI LEXMARK LEGAL SOT PËR NJË TË ARDHME MË TË
NDRITSHME NË MB. PARTNERI JUAJ I BESUAR I IMIGRACIONIT!

ANA: 07435119343 Office: 0208 090 2488
ALDO: 07494181220
SANTJOLA: 07742877853

The Winning Box, Aquis House,
27-37 Station Road, Hayes, UB3
4DX



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 10 JANAR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

CAMERON: DURIMI YNË DUHET TË KETË KUFI NË RAPORT ME SERBINË



PETRIT KUÇANA

**KUR TË MUNGON
SHTETI... EDHE
TEK ARKMORTI**



ARBEN MANAJ

**KONCENSION
I PAPRECEDENT
DIPLOMATIK
BRITANIK PËR
SHQIPERINË**


**DËSHMITË
E VIKTOR ÇAMIT**

DAUT DAUTI



**KËTA VJEDHIN
EDHE PROKURORIN**

LUTFI DERVISHI




**APOSTULLI
I ILIR IKONOMIT
NË NEW YORK**

MAL BERISHA



SHPRESA

LEA YPI



**SI TË BËHEN
EVROPIANËT
EVROPIANË**

VETON SURROI



Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545




The Albanian newspaper in London

www.thealbanian.co.uk


THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Fundviti solli për ta kobshëm, në përmasat e tragjike, s' humbjen e njeriut të shtrenjtë, për familjen e tyre. Leonard Farruku ishte vetëm 27 vjeç. Nuk mund ta besonte askush se fati kishte rezervuar atë tragjedi. Jeta e tij do të merrte fund në një anije kamp bashkë me ëndrrat e tij krejtësisht të njëjta me ëndrrat e mijëra e mijëra shqiptarëve.

KUR TË MUNGON SHTETI... EDHE TEK ARKMORTI

Lajmi më tragjik (si i dyti në llojin e tij në atë fundvit) ishte tronditës jo vetëm për çdo shqiptar, por për çdo qenie njerëzore që dëgjoji se si u këputën ëndrrat e dy të rinjve shqiptarë.

Kur akoma tragjedia e familjes Farruku për humbjen e djalit 27 vjeçar ishte e freskët, ata u përballën me një tragjedi të dytë; pamundësinë e sjelljes së arkmortit në Shqipëri.

Shteti shqiptar turpshëm, padinjitetshëm mungon. Mungon ftohtësisht, tmerrësisht keq edhe në këto momente që duhej më shumë.

Heshtja kaplon gjithandej, ambasada, zyra e institucione mbyllën dyer e dritare për të mos dëgjuar asgjë, për të heshtur, duke i shtuar dhimbjen e tragjedisë kësaj familje. Shteti, manaxhuesi i taksave shqiptare mungoi turpshëm. Shqipëria mungoi në Londër turpësisht.

E motra e Leonardit bëri përpjekjen e fundit, një apel për të ndihmuar të gjithë ata

që mundën për sjelljen e arkmortit në Shqipëri.

Krejt natyrshëm në një kohë rekord u bë e mundur mbledhja e fondeve të kërkuara nga shqiptarë dhe britanikë, por shteti mungoi.

Aty mori fund neni nr.8 i kushtetutës si detyrim ligjor dhe jo dëshire të atyre zyrtarëve që kanë marrë përsipër ato poste, ku nuk ka asnjë kuptim dhe asnjë lloj justifikimi që nga zyrtarët e ambasadës në Londër tek ata të ministrisë së jashtme e deri tek instancat më të larta të shtetit shqiptar.

Çdo ngrehinë shtetërore u shkërmoq turp-



shëm përpara arkmortit të Leonard Farrukut.

Pluhur e hi u bë çdo ligj si detyrim kushtetues i shtetit ndaj shtetasve të vet.

Ajo Shqipëria që do të kujdesej dhe shqetësohej shumë për refugjatët afrikanë

që do vinin në Itali dhe që ishte e gatshme të tregonte gadishmerinë e saj për ti strehuar në Lezhë dhe humanizmin e pakufijshëm për këta të mjerë, heshti për shtetasin e vet.

I preu në besë.

Nuk u dëgjua qoftë edhe një ngushëllim nga institucioni i presidentit, kryeministrit, as nga kryetarja e kuvendit, ministri i jashtëm e madje madje duhej që kjo tragjedi të mos përbënte as lajm sepse po cënokërka rëndë sukseset e qeverisë në prag të ndërrimit të motmoteve.

O tempora O mores

Heshtja erdhi si paralajmërim i ftohtë se shteti do të vazhdojë të mungojë edhe në të tilla raste, Manaxhuesi i parave të shqiptarëve i quajtur shtet mungoi turpshëm, frikshëm, padinjitetshëm.

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARET NË UK


Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA



**Imperium
Chambers**

Tel: 0207 242 3488

**Address: 2 Selkirk Road,
London SW17 0ES**

Email: enquiries@imperiumchambers.co.uk

Website: www.imperiumchambers.co.uk

YouTube: The Immigration Barrister

**A JENI MARTUAR PAS DATËS
31 DHJETOR 2020 DHE JU
ËSHTË REFUZUAR APLIKIMI
I EU SETTLEMENT SCHEME
(EUSS)?**

**DONI TË APELONI ÇESHTJEN
TUAJ NË SHKALLËN E PARË
APO TË DYTË TË APELIT?**



**ME NJË GARANCI SUKSESI TË LARTË NË TË GJITHË APELET BARISTERËT TANË TË KUALIFIKUAR
DHE ME EKSPERIENCË E NDJEKIN ÇESHTJEN TUAJ NGA FILLIMI NË FUND**

SHERBIMET QE OFROJME NE ÇESHTJET E EMIGRACIONIT PERFSHIJNE

Human Rights

Judicial Review

Appeals

(we have in house barristers)

Fresh claims

Asylum

Overstayers

Stateless

Detention & Bail

EEA family permit

EEA Permanent Residence

Indefinite Leave to Remain (ILR)

Nationality

Spouse Visa

Visitor Visa

Dependent children

Student,

Work & Entrepreneur Visa

Jemi te specializuar ne aplikimet per nderrimin
e shtetesise nga **Kosovar** ne **Shqiptar**

Per me shume informacion kontaktoni Adelen

Fully accredited by the
Bar Standard Board



**BAR
STANDARDS
BOARD**

Imperium Chambers

4.8 ★★★★★ (141) ⓘ

Lawyer in London, England · [Open](#)

Mob:

07901181592



ARBEN MANAJ

Sipas njoftimeve zyrtare asnjë emigrant nuk është pikasur të kalojë ilegalisht përmes kanalit të La Manshit gjatë 25 ditëve të fundit, ç'ka përbën periudhën më të gjatë kohore që nga shkurti i vitit 2020.

Gomonia e fundit që ka mbërritur në brigjet angleze me 55 azilkërkuese në bord daton në 16 dhjetor të vitit të kaluar, ndërkohë që një ditë më parë kishte pasur shtatë gomone me një total prej 292 emigrantë në to. Kjo pauzë në tentativat për kalime të paligjshme drejt brigjeve britanike, ka ndodhur në një kohë kur një i ftohtë i acartë dhe kohë me reshje dëbore ka goditur tërë këto javë në shumë pjesë të Britanisë së Madhe.

LA MANSH, 25 DITË ASNJË GOMONE! SHKAK KUSHTET E VËSHTIRA ATMOSFERIKE

Stuhia Henk, goditi Britaninë në 2 janar me një shpejtësi ere prej 151 km në orë, ç'ka shkaktoi dallgë të jashtëzakonshme. Në kushtet e kësaj kohe, shumë linja tragetesh mes Francës dhe Anglisë anuluan udhëtimet detare. Pas kësaj stuhie, pasoi një tjetër, e quajtur stuhia Gerrit, ç'ka anuloi udhëtimet detare për tre ditë me radhë.

Kryeministri Rishi Sunak e ka bërë moskalimin e gomoneve një ndër prioritetet e tij përpara zgjedhjeve, ndërkohë që ai pati një lajm të keq ditë më parë kur sipas shifrave të rrjedhura nga institucionet qeveritare, tregojnë se kalimet gjatë këtij viti, mund të shkojnë në 35 mijë vetë, madje mund të shkojnë në 50 mijë sipas një projekcion më të lartë.

Një tjetër informacion negativ për qeverinë britanike të Sunak, ishte edhe një raport francez ku pretendohet se Britania nuk bashkëpunon me



përpyekjet për të penguar kalimet me gomone, ndërkohë Ministria e Brendshme, Home Office, e hodhi poshtë

këtë raport duke thënë se ai është i bazuar mbi një sistem të vjetruar, informacioni dhe nuk reflekton saktë-

sisht marrëdhëniet aktuale të bashkëpunimit franko-britanik.

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.

- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

LEXMARK LEGAL

EKSPERTËT TUAJ TË BESUAR NË LIGJIN E
EMIGRACIONIT

A PO KËRKONI NDIHMË PROFESIONALE PËR ÇËSHTJET E EMIGRACIONIT?

Mos kërkoni më tej! Lexmark Legal është ekipi juaj i kërkuar i avokatëve ekspertë të imigracionit në Londër, të përkushtuar për të ofruar zgjidhje ligjore të nivelit të lartë të përshtatura për nevojat tuaja.



PSE TË ZGJIDHNI LEXMARK LEGAL?

- Profesionistë me përvojë të imigracionit
- Zgjidhje ligjore të personalizuar
- Ekspertizë e shumëanshme
- Përkushtuar për suksesin tuaj
- Qasje e dhembshur dhe e kujdesshme

Gati për të ndërmarrë hapin e parë drejt zgjidhjes së shqetësimeve tuaja ligjore? Kontaktoni avokatët e imigracionit ligjor të Lexmark dhe na lini të jemi partneri juaj ligjor i besuar.


CONTACT US

ANA: 07435119343

ALDO: 07494181220

SANTJOLA: 07742877853

OFFICE: 0208 090 2488

 The Winning Box, Aquis House, 27-37 Station Road, Hayes, UB3 4DX

SHËRBIME TË REJA:

- 1. Mbështetja e Legjislacionit Civil:**
Lundrimi përmes legjislacionit civil mund të jetë kompleks, por mos u shqetësoni! Profesionistët tanë të kualifikuar ligjorë janë këtu për t'ju udhëhequr në çështje të ndryshme të së drejtës civile. Nga mosmarrëveshjet e kontratave të drejtat pronësore, ne ju kemi mbuluar me këshilla dhe përfaqësim gjithëpërfshirës.
- 2. Ndhmë e dhembshur për të drejtën e familjes:**
Ne i kuptojmë ndjeshmëritë e përfshira në çështjet e së drejtës familjare. Qoftë divorci, kujdestaria e fëmijës ose birësimi, ekipi ynë empatik është i përkushtuar për t'i zgjidhur çështjet familjare me kujdes, duke siguruar rezultatet më të mira të mundshme për ju dhe të dashurit tuaj.
- 3. Shërbime të fuqishme të mbrojtjes kriminale:**
Kur përballeni me akuza penale, të kesh një mbrojtje të fortë ligjore është thelbësore. Avokatët tanë me përvojë janë njohës të mirë të ligjit penal dhe të përkushtuar për të mbrojtur të drejtat tuaja. Nga konsultimet ligjore të përfaqësimi në sallën e gjyqit, ne jemi këtu për të luftuar për drejtësinë tuaj.

CAMERON: DURIMI YNË DUHET TË KETË KUFË NË RAPORT ME SERBINË

Sekretari i jashtëm britanik David Cameron deklaroi se qeveria britanike është e pakënaqur me qëndrimet e Serbisë ndaj Kosovës.

Në një raportim para anëtarëve të Komisionit për Politikë të Jashtme të parlamentit britanik, zoti Cameron, i cili vizitoi Kosovën javën e kaluar, tha se qeveria e tij është e përkushtuar që Serbisë t'i mundësohet integrimi evropian, por shtoi se sulmi i grupit të armatosur serb në pjesën veriore të Kosovës në muajin shtator, një ndër incidentet më të rënda në Kosovë, "paraqiti një rrezik të madh" për sigurinë e rajonit.

"Nuk e kemi ndryshuar qëndrimin që t'i japim Serbisë mundësinë të ketë të ardhme euroatlantike. Nuk e kemi ndryshuar qëndrimin se nëse Serbia e do këtë rrugë, asaj do t'i ofrohet kjo e ardhme," deklaroi zoti Cameron. "Por ndjej një pakënaqësi në rritje për mënyrën si po sillet (Serbia), që po bën këto gjëra dhe duhet të jemi të qartë për këtë."

Ai deklaroi se nuk mund të thotë nëse Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara ndajnë të njëjtin mendim, por theksoi se në bazë të bisedave që ka patur "kam përshtypjen se ekziston pakënaqësi, pasi e kuptojmë se Banjaska ishte një rrezik i madh."

Sekretari Cameron, vendi i të cilit ka 600 forca paqeruajtëse në Kosovë, i bëri këto deklarata në përgjigje të pyetjeve të deputetes britanike Alicia Kearns, e cila kërkoi të dinte qëndrimin e Britanisë së Madhe për sulmin në Banjaskë.

"Mendoj se është e rëndësishme për Britaninë e Madhe të shpjegojë se çfarë ka ndodhur atë ditë, pasi Vuçiçi mohon atë që ka ndodhur atë ditë. NATO-ja i shpërfilli shqetësimet e mia kur theksova vitin e kaluar se armët po futeshin ilegalisht në Kosovë dhe po fshiheshin në kisha," tha gjatë debatit deputetja Kearns, duke e pyetur zotin Cameron nëse ishte e mundur që "Bashkimi Evropian dhe SHBA të ndryshonin qëndrim për të patur një pozicion më të drejtë ndaj Kosovës."

Zoti Cameron tha se mendon se "qëndrimi i Perëndimit, sa i përket Kosovës dhe Ballkanit Perëndimor, është hartuar para agresionit të Rusisë në Ukrainë dhe duhet të mendojmë shumë se çfarë ka ndryshuar."



"Rusia dëshiron ta destabilizojë Ballkanin, dëshiron ta bëjë këtë përmes aleatëve të saj, përfshirë Serbinë dhe dëshiron t'i bëjë këto shtete, përfshirë Moldavinë, më pak të sigurta. Ne duhet të jemi të gatshëm që ta luftojmë një përpjekje të tillë, deklaroi ai.

Ai shtoi se politika e Britanisë së

Madhe në rajon duhet të vazhdojë "të jetë e fortë dhe realiste."

"Durimi ynë duhet të ketë një kufi," deklaroi zoti Cameron.

Pas sulmit në Banjaskë më 24 shtator diplomatët perëndimorë u vunë në përpjekje të reja për të përshpejtuar procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve mes shqetësimeve për qëndrueshmërinë në

rajon.

Nga Qeveria e Kosovës kërkohet të themelojë Asociacionin e komunave me shumicë serbe, ndërsa Qeverisë së Serbisë të përmbushë detyrimet që çojnë drejt njohjes de fakto të Kosovës.

Beogradi ka theksuar se nuk do të zbatojë asgjë që çon në njohjen e Kosovës.

Ndërkohë dyja palët kanë lejuar lëvizjen e lirë të makinave, pas muajsh përplasjesh që çuan në thellimin e tensioneve në pjesën veriore të Kosovës.

Me 25 dhjetor Beogradi vendosi të lejojë lëvizjen e makinave me targa të Kosovës duke vendosur afishe në vendkalimet kufitare në të cilat thuhet se mundësi i kalimit të kufirit me targa RKS bëhet "për arsye krejtësisht praktike", që liria e lëvizjes të bëhet më e lehtë, dhe nuk mund të interpretohet si njohje e pavarësisë së "Kosovës".

Qeveria e Kosovës po ashtu më 4 janar miratoi vendimin për largimin e regjimit të letër ngjitëseve për makinat me targa të Serbisë./VOA


FOTOGRAFIA PROBLEMATIKE

DAUT DAUTI

Sa i përket Ballkanit dhe çështjes shqiptare, Lord Cameron është pasardhës i një politike konservative, themelues i së cilës në Britani të Madhe është Aubrey Herbert. Herbert në histori ka hyrë si miku më i madh që shqiptarët kanë pasur deri tash.

Herbert, ushtarak, diplomat, anëtar i partisë konservative dhe deputet në parlamentin britanik, me 'Albanian Committee' që e themeloi në Londër, ka luajtur rol të pazëvendësueshëm në popullarizimin e kauzës shqiptare dhe në pavarësimin e Shqipërisë. Herberti dhe Isa Boletini kanë qenë miq të ngushtë. Në fakt, Isa Boletini ka qenë heroi i Herbertit.

Pra, Aubrey Herbert është themelues i klimës proshqiptare në mesin e konservativëve britanikë. Punën e



tij e kanë përcjellur Edith Durham, që pasoi të Noel Malcolm e pastaj të Tony Blair dhe të trashëgimtari i sotëm i rëndësishëm i konservativëve, Lord Cameron - garantuesi i sovranitetit të Kosovës. Atë që e tha Cameron në Prishtinë, rrënjët i ka të Herbertit.

Por, presidentja, në mënyrë të pakuptueshme, nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë. Ndoshta ajo nuk e ka parasyshtë se miqësitë duhet të kultivohen.

Për këtë arsye para më shumë se një viti presidentes së Kosovës i është dërguar një kërkesë që ta dekorojë Aubrey Herbertin.

Me këtë rast do të shpreheshin falënderime dhe mirënjohje për miqësinë dhe

ndihmën e madhe që kanë dhënë britanikët për Kosovën.

Derisa presidentja e Kosovës nuk e dekoron Aubrey Herbertin, njeriun më të rëndësishëm të miqësisë britanike dhe paraardhësin politik të Lord Cameronit, kjo fotografi le t'i qëndroj si përkujtim problematik dhe ndoshta si brejtëse e ndërgjegjes.

Derisa presidentja e Kosovës nuk e dekoron Aubrey Herbertin, njeriun më të rëndësishëm të miqësisë britanike dhe paraardhësin politik të Lord Cameronit, kjo fotografi le t'i qëndroj si përkujtim problematik dhe ndoshta si brejtëse e ndërgjegjes.

IVL Accountancy

SERVICES

PAYROLL SERVICES (INCLUDING CIS)
ANNUAL ACCOUNTS AND TAX RETURNS
CONFIRMATION STATEMENT
/ ANNUAL RETURN
VAT RETURNS
BOOKKEEPING
SELF-ASSESSMENT/ PERSONAL TAX
CLOUD ACCOUNTING
COMPANY INCORPORATION
(IF REQUIRED)
VAT REGISTRATION (IF REQUIRED)
PAYE REGISTRATION (IF REQUIRED)
CIS REGISTRATION (IF REQUIRED)
FINANCIAL REFERENCE
ETC

Broxbourne, EN10 6HS

Tel :

07749 590078

info@ivlaccountancytld.co.uk



Nese ju nevojitet nje llogaritar profesional mos hezitoni te kontaktoni INEN

07749 590078

PROVIDING CLIENT ADVICE & SUPPORT REGARDING FINANCIAL

HELP AVAILABLE AS A RESULT OF

COVID-19 CRISIS

(for companies & Self-employed)

ARBEN MANAJ

KONCENSION I PAPRECEDENT DIPLOMATIK BRITANIK PËR SHQIPERINË

Ceshtja e emerimit kontravers dhe te mediatizuar te Ambasadorit te ri shqiptar ne Londer, ka dritehije jo te pakta dhe nuk do duhet te ishte e ketille, ne rast se Shqiperia do aplikonte si deri me sot, ne menyre strikte dhe korrekte Nenin 8 te Marreveshjes se Vjenes per Marredheniet Diplomatike te vitit 1961.

Ky nen thekson ne Piken 1 se "Anetaret e stafit diplomatik te misionit duhet ne parim te jene te kombesise se shtetit qe i dergon". Nderkohe ne Piken 2 thuhet se "Anetaret e stafit diplomatik mund te mos emerohen nga rradhet e personave qe kane kombesine e shtetit prites, me perjashtim kur jepet pelqimi i atij Shteti, pelqim qe mund te terhiqet ne cdo kohe".

Pra, Britania mund te mos e pranonte emrin e ambasadorit te ri shqiptar, per shkak se ai ashtu si edhe une dhe mijera shqiptare te tjere qe jetojme ne Britani, kemi dyshtetesi. Njerezit me shtetesi dhe kombesi te dyfishte, mund te mos mbajne pozicione si shefa te misioneve diplomatike ne Britani, vetem me perjashtim kur jane Komisionere te Larte, te vendeve ish-koloni te Britanise, si dhe Ambasador te Republikes se Irlandes.

Fillimisht, shqetesimin per emerimin e Ambasadorit te ri shqiptar, e ngriti ish-Ministrja e Brendshme britanike, e njohur per qendrimet e asaj anti-shqiptare, Suela Braverman, shqetesim qe nuk mund te thuhet me saktesi, nese ka qene i motivuar nga anti-shqiptarizimi i saj apo te qenit strikt me protokollet e sigurise se shtetit, Minsitre e Brendshme e se cilit ajo ishte, deri para se te prishej perfundimisht politikisht me kryeministrin e saj, Rishi Sunak, i cili e shkarkoj ate.

Por ky ngerc, u tejkalua nga Forin Ofisi dhe drejtuesi i ri i saj ish-kryeministri David Cameron, qe normalisht nuk e ka bere nje gje te tille me koke te vete, pa u konsultuar me bosin e tij, kryeministrin Sunak.

Ne interpretimin dhe gjykimin tim modest, pasi jetoj dhe punoj prej 31 vjetesh ne Britani, ketu duhet gjetur edhe koncesioni i paprecedent britanik ne marredheniet diplomatike me Shqiperine.

Nje koncension te tille me sa di nuk e ka bere Vjena per Ambasadorin e ri te emeruar shqiptar ne Austri, te pakten deri para pak kohesh, i cili ka edhe ai shtetesi te dyfishte. Por Austria, dhe Vjena vendi qe ka marre emrin Protokolli Diplomatik Nderkombetar, qe rregullon marredheniet diplomatike mes shteteve, nuk ka dalje ne det dhe shqiptaret nuk shkojne me gomone ne Vjene, edhe pse ka Danubin blu.

Shqiptaret as nuk shkojne ne numra te atille te medhenj ne Austri sa vijne ketu ne Britani.

Nisur nga ky kontekst politik dhe migrator, Tirana eshte shume e rendesishme, sidomos ne kete vit te ardhshme elektoral, per Londren politike, per shkak te krizes se kalimeve ilegale te shqiptareve dhe jo vetem



atyre, permes La Manshit, ku Tirana i ka bere nje nder te jashtezakonshem politik qeverise konservatore te Rishi Sunak, me marreveshjen e dhjetorit te 2022-shit, per rikthimin ne Shqiperi, te te gjitha shqiptareve qe vijne ilegalisht ne Britani.

Argumentueshem, Tirana zyrtare do duhet te bente me shume per interesat e shqiptareve qe nderkohe jetojne te pategalizuar ne ishull, dhe ne menyre transakionale mund te arrinte nje marreveshje me perfitim reciprok, sic beri Kigali dhe presidenti i shtetit te Afrikes ekuatoriale, Paul Kagame.

Ruanda, e cila e kapi ne ajer, marreveshjen e Londres per dergimin e azilkeruesve, te cilen e refuzoj Rama, por qe ia pranoi Italise per marrjen e refugiateve qe vijne nga Afrika apo zona te tjera te luftes, qe ne shumice kane destinacion Britanine dhe vendet e begata te Evropes veriore, duke perfituar rreth 300 milione sterlina pa derguar asnje azilkerkues ende ne Ruanda, 9 ore larg me avjon nga Londra, si dhe lehtesira madje, edhe marreveshjen e Ruandes per t'u vendosur e jetuar ne Britani.

Nisur nga ky interes i jashtezakonshem i Londres, qe u pa edhe ne takimin ne Rome mes Melonit Rames dhe Sunakut, gjate ketij muaji, dhe nje Zot e di se cfare do rezultate pas ketyre bisedimeve pas kuintave, sic ndodhi me marreveshjen e Italise, me gjase e arritur ne kohen e vizites ne Vlore te Melonit gjate veres, ku ceshtja e ikjes pa paguar te disa te rinjeve italian nga nje restaurant ne Berat ishte spin doctoring i asaj vizite te Melonit, e cila habiti te gjitha me sekretin e marreveshjes se arritur mes

Romes dhe Tiranës.

Koha do tregoj ate qe mediat britanike thone kur shkruajne se c'na duhet Ruanda kur kemi Tiranen per dergimin e azilkerkuesve.

Pikerisht, kjo rrethane qe rrezikon jo pak fatet elektorale te konservatoreve te Rishi Sunak ne Britani, mund te jete arsyeja e leshimit diplomatik britanik ndaj deshires dhe investimit direkt te Rames per te emeruar dhe katapultuar si Ambasador ne Londer nje shqiptaro-britanik, te panjohur dhe pa asnje dite ne sherbimin diplomatik shqiptare. Dhe ka precedent te tille Shqiperia, si me ish-Ministrin e Jashtem te ardhur nga Kosova, qe nuk e njihje njeri deri ne ate kohe e qe deshtojte ne menyre spektakolare.

Personalisht, nuk e njoh fare dhe nuk e kam takuar asnjehere Ambasadorin e ri, dhe do te doja ta takoja pasi te marr postin, kuptohet pa i prishur pune, sic mund te kem takuar shume shqiptare tejet te sukseshem ne Londer apo Britani, dhe sinqerisht i uroj suksese ne detyren e re, per te ndryshuar shume funksionimin e misionit diplomatik ne Londer, qe keto pese-gjashte vitet e fundit eshte nder me te dobetit ne sherbimin dhe historine e misioneve diplomatike shqiptare ne Londer.

Ai vertet mund ta flas shume mire anglishten, dhe s'ka perse anatemohe se ka ardhur i fshehur ne kamion dikur si azilant, dhe ky fakt nuk duhet kurresesi konsideruar si mekat i tij, sic ka ndodhur nga media dhe tabloid ksenofobe britanike. Absolutisht jo. Sot ai eshte shtetas britanik dhe shqiptar, si edhe une qe kam me shume vite se ai ne Londer. Por fakti qe eshte

mjaft i sukseshem, sic raportohet ne fushen e vete te shkences dhe sistemin bankar, nuk mendoj se perben, argumentueshme serish, arsye te qenesishme per te qene nje kandidat i perkyrer per Ambasador, dhe do uroj te na provonte gabim ne skeptikeve, pa ushtruar asnje dite nga jeta e vet ne sherbimin diplomatik shqiptar, c'ka per mua eshte mangesi, sic besoj mendojne shume diplomat, dhe jo vetem shqiptar.

Nese eshte, sic njofton media britanike, njeri qe ka lidhje me udheheqjen e larte te Partise Socialiste ne pushtet, serish kjo nuk do ishte e mjaftueshme, nese do zbatoheshin rregullat e karrieres se sherbimit diplomatik shqiptare. Ose shume mire, mund te jete rasti qe ne ate sherbim, momentalisht nuk ka njerez kaq te afte ose kane mbaruar ata qe mund ta bejne punen e Ambasadorit shqiptar ne Londer. Dhe kjo do ishte fatkeqesi per diplomacine shqiptare.

Dhe ketu qendron defekti dhe arroganca ne emerime te tilla.

Anglishte te folur ne menyre perfekte ka me mijera shqiptare qe e flasin ne Britani, madje shume me te mire se e imja, qe kam studiuar per Anglisht dhe jetoj prej tre dekadash ne Londer, apo qe edhe kane me shume kohe qe jetojne dhe punojne ne institucione prestigjioze te shtetit britanik dhe jane krenari e komunitetit, dhe jane po aq apo edhe me te sukseshem ne profesionet e tyre, sesa Ambasadori i ri i caktuar nga Rama.

Njera prej tyre, mund te ishte edhe Lea Ypi p.sh, aq me teper qe punon ne nje institucion prestigjioz akademik, dhe qe e ka shume te mire marredhe-

nien personale me Ramen, edhe pse vjen me prejardhje nga nje familje politike shume ndryshe nga ajo e Kryeministrin apo e imja.

E nese doni, strik mbi kriteret profesionale, edhe ish-diplomat karriere, madje edhe ndonje ish-zv Minister te Jashtem te Shqiperise qe punon sot ne BBC, me siguri i'a dine emrin, e ai flet anglisht po aq, ne mos me perfekte se ambasadori i ri apo e njeh politiken dhe diplomacine padyshim shume me mire se ambasadori ne fjale, fale pervojës.

Londra ka nevojë për klas shume te larte perfaqesimi politik dhe diplomatik dhe ambasador qe mund ti marresh nga Londra dhe direkt ti besh Ministra te Jashtem apo sic ka ndodhur edhe perfaqesues te larte te vendit ne institucionet me te rendesishme te politikës evropiane dhe te Bashkimit Evropian, sic ka ndodhur, te ardhur nga posti i Ambasadorit ne Londer, si rasti i zotit Mazi. E ketu nuk duhet ceduar.

Britaniket dukshem kane bere "rokade diplomatike", me nje koke ambasadori per te mbajtur te lumtur Ramen, i cili mban te lumtur Sunak, duke rikthyer mbrapsht mijera shqiptare qe vijne ilegalisht ne ishull, duke kaluar nje kalvar te frikshem e duke bere selfie me vdekjen, maje gomoneve ne ujerat e akullit te Detit te Veriut, pa ditur nese do mbrijne gjalle ne anen tjetër te bregut apo jo. Ambasadori i ri shqiptar ne Londer, do duhet vleresuar edhe per nje fakt tjetër, qe le te ardhura besoj shume me te majme nga puna si specialist i sukseshem ne banka apo si researcher universitar ne insitucione akademike elitare, per nje rroge mediokre Ambasadori shqiptar e cila eshte denigruese dhe e pamjaftueshme per standartin e jeteses ne Britani.

Dhe ka shembuj te tjere perpara tij qe perfaqesues te Rilindjes kane lene poste te mirepaguar, qofte edhe nga Londra, apo si zv-kryeministrja aktuale e cila ne krye te Alb Control-it merrete dikur tek 6-7 mije sterlina ne muaj, per t'u paguar 1 a maksimumi 2 milione leke shqiptare ne postin qe ka!

Por kjo ndoshta eshte ceshtje besnikerie dhe perkushtimi personal ndaj atdheut, apo devotshmeri ndaj sponsorizuesit te kandidimit te tyre, dhe jane sakrifica qe jo shume shqiptare do e benin pas 30 vjetesh te jetuar jo lehtesisht ne kapitalizem, aq me teper ne vendin ku ka lindur kapitalizmi.

Dhe per kete sakrifice, pa medysheje, Ambasadori i ri ne Londer do duhet vleresuar, pasi nuk eshte vendim i lehte per te pranuar oferten e re te punes, me renie drastike ne te ardhurat personale nga puna si Ambasador.



DAUT DAUTI

Një natë gushti të vitit 1942 Pallati Mbretëror i Egjiptit ka përgatitur një darkë solemne për një mysafir shumë të rëndësishëm.

Atë natë, mbreti Faruk e ka gostitur kryeministrin britanik, Winston Churchillin. Gjatë darkës dhe muhabetit, Churchilli e heton se në xhep nuk e kishte orën. Kjo gjë e kishte brengosur pa masë për shkak se ora ka qenë e shtrenjtë dhe është bartur në familje me gjenerata si dhuratë nga familja mbretërore britanike.

Kur Churchilli ishte shqetësuar tej mase, mbreti Faruk i thotë: "Unë e kam orën tënde. Ja ku e ke. E mora për argëtim se ju anglezët jeni të njohur për humor".

A do t'ia kishte kthyer orën mbreti Faruk Churchillit sikur ky të mos e diktonte sa ishte ende në pallat?

Pse vjedh një njëri, në këtë rast mbret, dhe ndër më të pasurit në botë? Mbreti Faruk ka qenë edhe koleksionari më i madh i automobilave (vetëm Rolls Rojssa i kishte mbi 50), disa dhjetëra Mercedes (më i shtrenjtë ishte dhuratë që ia kishte dërguar Hitleri për martesë), mijëra orëve të shtrenjta, qindra e qindra diamante e gurë tjerë të çmuar, një mori të fotografive dhe filmave pornografikë dhe shumë gjëra tjera. Sipas vlerës së sotme, pasuria e mbretit Faruk llogaritet me vlerë 100 miliardë euro. Mbreti Faruk ka vjedhur për shkak se ka qenë kleptomaniak. Pra, vjedhjen e kishte sëmundje.

Mbreti Faruk ka qenë specialist i vjedhjes në xhepa. Pra, ka qenë xheparosh. Nga dëshira për ta mësuar këtë 'mjeshtëri', e kishte nxjerrë nga burgu hajnin më të madh të xhepave në Kajro, i cili, pas një kursi intenziv, ia kishte mësuar mbretit zanatin. Prob-



lemi i mbretit ishte se, nuk kishte ku të vidhte pasi që shumicën e kohës e kalonte në pallat dhe nuk mund t'i vidhte gjërat e veta.

Por, disa historianë kanë shënuar se ai vidhte edhe si mysafir kur shkonte në vizita zyrtare. Ta zëmë, një gjë të vlefshme që dihet se e ka vjedhur, është shpata ushtarake solemne e

Rezah Pahlavit. Sidoqoftë, mbreti Faruk ka qenë karakter i veçantë dhe bënte gjëra të çuditshme. Në kohën e tij, për shkak të mënyrës si jetonte, ka qenë ndër personalitetet më të popullarizuara në botë. Nuk kishte besim në askend pos te një grup i 60 shqiptarëve që i mbante afër. Ishte shumë i dhënë pas ushqimit dhe

grave. Hante deri 600 guaca deti brenda një jave edhe pse e dinte se nuk duhej t'i hante më shumë se 70 pasi që mund t'ia shkaktonin vdekjen, e cila gjë edhe i ndodhi.

Para pak kohësh janë zbuluar memoaret e tija, por ende nuk janë botuar. Duhet të jenë interesante.

Mediat arabe kanë botuar disa pjesë ku ai thotë se nga fronti e largoi 'Vëllezëria Myslimane' e jo 'Lëvizja e Officerëve' e Naserit, siç është ditur deri tash.

Sidoqoftë, viteve të fundit është shtuar interesimi për të në botën arabe ku janë shkruar shumë libra dhe janë xhiruar filma artistikë e dokumentarë. Vërehet një tendencë e paraqitjes së figurës së tij në aspekt pozitiv dhe në Egjipt janë shtuar zërat për kthimin a pasardhësve të tij në fron.

Megjithatë, sikur të mos ia kthente Churchillit sahatin, do të ishte më interesant. Thjeshtë, është dashtë t'i thotë: "Kur ke hy n'pallat, nuk e ke pasë sahatin me veti".

Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI SHQIPERI - ANGLI

SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh

BRITANI

Londër - Birmingham
Manchester - Leeds - Luton

NA KONTAKTONI

📞 UK: 00447429200952
📞 AL: 00355682948843
📞 AL: 00355694031009

TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI

+44 7741 588799

+355 67 728 2828

SHQIPËRI

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

ANGLI

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë

Ju Faleminderit qe na besoni!

Dotech

websites

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google



NA KONTAKTONI



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e Zyrove
30 Avenons Road
London E13 8HT

LEA YPI

Shumica e njerëzve mendojnë se shpresa qëndron diku mes një dëshire dhe një besimi, mes dëshirës për një rezultat të kënaqshëm, dhe besimit të realizimi i dëshirës. Nëse dëshira dhe besimi përputhen, kemi shpresë, përndryshe jo.

Për mua shpresa është diçka tjetër. Të kesh shpresë nuk ka të bëjë me se si rrjedhin ngjarjet.

Shpresa është një plotësues i domosdoshëm i moralit.

Pse të përpiqemi të bëjmë atë që duhet bërë nëse të tjerët nuk sillen njësoj?

Pse t'i bëjmë të tjerët përgjegjës, nëse mendojmë se përgjegjësia është përtej aftësisë së tyre?

Shpresa është e kundërta e nihilizmit. Paradoksisht, sa më keq të na shkojnë punët, aq më shpresëplotë duhet të mbetemi për të vazhduar luftën.

Të jesh shpresëplotë nuk ka të bëjë me garancinë për rezultatin e pritur, por me ruajtjen e parimit të duhur, parimin mbi të cilin ka kuptim një

SHPRESA



botë morale.

Në rastin tim, ta humbas shpresën, do të thotë të humbas besimin në atë parim.

Të mendosh duke e vendosur veten në vendin e gjithë të tjerëve, ky është parimi i të menduarit të ndritur. Nuk është aq abstrakt sa duket, as aq individualist, apo i lidhur me status quonë e përkohshëm.

Përkundrazi, është vendimtar për të plotësuar boshllëkun mes botës në të cilën jetojmë, dhe asaj që kemi përgjegjësinë të ndërtojme.

Kur u flisja për këtë studentëve, mes habitës, njëri prej tyre tha: Kanti ishte me fat që jetoi në epokën e Iluminizmit, në kohën e tij njerëzit e pëlqenin iluminizmin.

Një tjetër vuri në dukje se në

shkullin e 18-të nuk kishte algoritme dhe media sociale. Për këtë arsye ishte ende e mundur të besohej në iluminizëm përmes diskutit publik.

Një studente, këtë herë nga Ballkani tha: E çfarë bëri iluminizmi për ne përderisa nuk na na ndihmoi të ndalonim genocidin?

Pas këtyre ndërhyrjeve, gjithçka që kisha thënë deri në atë moment mu duk qesharake.

Kishte, pra, një hendek mes botës së leximeve, dhe asaj në të cilën jetoja. Sipas mediave sociale dhe lajmeve, vrasja e civilëve të pafajshëm, ndonjëherë, për disa njerëz, dhe në disa kushte, është e paevitueshme.

Po a mund t'i besohet iluminizmit dhe mendimit të hapur para standardeve morale të dyfishta? A nuk është absurde të besosh se politika mund të mbetet përgjegjëse ndaj moralit?

Nuk ishte hera e parë që bluaja në kokë të tilla mendime. Shpesh i kujtoja vetes detyrën morale për të shpresuar.

Por ngeci, filloi të mos funksionojë.

Mesa duket kisha humbur besimin të arsyeja, dhe fjalët e mia kishin humbur fuqinë për të pasur kuptim, madje

edhe për veten time.

Për të ardhur në vete, u përpoqa, së pari, të kujtoja qëndrimin tim të kahershëm përballë botës, dhe si dëshpërimi im ekzistencial, dilemat e mia filozofike dhe pyetjet e mia të vazhdueshme, në fund të fundit përbënin një privilegj.

Njerëzit që vuajnë nga padrejtësia, që përballojnë fyerjet e përditshme të dinjitetit të tyre, që janë të shtypur, të heshtur, të shfrytëzuar, të lënë të vdesin ose të vriten, nuk ja kanë ngenë ta pyesin veten nëse kanë ose nuk kanë shpresë. Ata ngjiten pas jetës, përpiqen ta përballojnë, punojnë, lodhen, sakrifikojnë.

Mes përpjekjeve të tyre të vazhdueshme, të çfarëdo forme qofshin, nuk ka hapësirë për humbjen e besimit.

Në këto rrethana, më e pakta që mund të bëjmë ne të tjerët, është të shmangim vënien në dyshim të arsyeve për të pasur shpresë. Ky është kuptimi i iluminizmit.

Ka shpresë apo jo? Kjo është pyetje për pakicën e lumtur që ka privilegjin të dyshojë.

The Guardian

DAUT DAUTI

Viktor Çami, i cili vdiq para tri ditësh në Angli, ka qenë njeri i dijshtëm, i dashur dhe patriot. Viktori ka lindur në Vjenë nga nëna austriake kurse babai i tij ka qenë Aziz Çami. Siç shihet nga mbiemri, Azizi ka qenë nga Çamëria, i lindur në fshatin Janjar të rrethit të Konispolit. Në vitin 1920 Azizi ka qenë komandant i forcave shqiptare në Luftën e Vlorës pasi që kishte të kryer akademinë ushtarake në Torino të Italisë. Më vonë ai i bashkohet KONARE-s (Komitetit Revolucionar) së bashku me Hasan Prishtinën, Fan Nolin, etj. Në vitin 1931 Azizi ka qenë njëri nga atentatorët ndaj Ahmet Zogut që ndodhi në shkallët e Operës në Vjenë. Në vitin 1943 komunistët e vranë Azizin në Tiranë pasi që ai ishte anëtar i rëndësishëm dhe nga komandantët kryesor i forcave të Ballit Kombëtar.

Nga kjo vrasje, biri i tij Viktori, së bashku me nënën, detyrohen të kthehen në Vjenë. Pas Luftës së Dytë Botërore, Viktori punësohet në BBC. Pasi që ishte njohës i mirë i disa gjuhëve, përfshirë shqipen dhe gjuhën amtare (gjermanishten), nga viti 1976 deri më 1990, Viktori ka punuar si përkthyes dhe analist në ambasadën amerikane në Vjenë dhe Londër. Me fjalë tjera, Viktori ka qenë njeri afër informatave që janë filtruar nga diplomatët amerikanë në Vjenë dhe Londër. Duke u bazuar në këtë njohuri, ai e ka shkruar librin 'Letra nga Mërgimi' që janë dëshmi interesante dhe të rëndësishme.

Më poshtë mund t'a lexoni një fragment nga libri i tij, që ka të bëjë me mendimet e tija për demonstratat e vitit 1981 në Kosovë dhe jehonën e tyre në Shqipëri dhe në botë:

Kosova dhe qëndrimi i shtetit shqiptar më 1981

Të gjithë analistët janë dakord se kyç i gjithë enigmës shqiptare, në çdo fazë të zhvillimeve, është dhe mbetet çka njihet si "Faktori K", dmth, Kosova. Pas heqjes së Rankoviqit dhe "liberalizimit" në Kosovë (pikërisht në atë kohë që mbyllet sekcioni shqiptar i BBC-së) dhe që kishte natyrisht objektiva strategjike të caktuar, pritej një ndikim në Shqipëri, herët ose vonë, sidomos pas prishjes me Kinën. E kundërta ndodhi: Faktori K shpërtheu fuqishëm më 1981. «Zëri i popullit» botoi artikullin: „Pse u përdor forca policore në Kosovë?” Filloi të „digjet stralli“ nën këmbët e titistëve. Reagimi në botë ishte: në fillim habi, pastaj nervozizëm, alarm, gati panik. Ishin bërë llogaritë pa hanxhinë! Po na prishej balanca e vendosur në Jaltë! Vetëm atëherë filloi bota (njëlloj si Lindja edhe Perëndimi) për herë të parë ta vështronte Shqipërinë „seriozisht.”

Duhej rivlerësuar gjendja. Duhej vendosur çfarë qëndrimi të mbahej ndaj këtij zhvillimi të ri dhe krejt të papritur. U vendos (njëlloj në Lindje si në Perëndim) se ngjarjet në Kosovë nuk ishin në interes të fuqive të interesuara: u denoncuan si shprehje të "nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar". U këshilluan kosovarët të rrijnë urtë dhe të ulin kokën, të nënshtrohen. Pozitat e Beogradit u mbështetën prej të gjithëve, hapur ose jo hapur: ishin shqiptarët fajtorë! Kur u mbajt Kongresi i tetë i PPSH në 1981 (i fundit për Enver Hoxhën) parulla e vëzhguesve ishte: „Kosova zien ... E gjithë bota i ka drejtuar sytë kah Tirana“. Pritej se ç' do të thoshte

DËSHMITË E VIKTOR ÇAMIT



“Shqiptari më i madh i të gjitha kohërave”, se çfarë qëndrimi do të mbante Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë.

A mund të më thoni, miku im i dashur – në këto rrethana – se Enver Hoxha mund të kishte hequr qoftë edhe një presje të vetme në pjesën përkatëse të raportit të tij? Ai e dinte fare mirë se presionet do të intensifikoheshin në maksimum po të mos hiqte dorë nga përkrahja e tij për lëvizjen kosovare. Ai e dinte fare mirë efektin që do të kishte një bllokadë ekonomike (e pashpallur, natyrisht) mbi ekonominë shqiptare dhe mbi perspektivën e rritjes, nivelin e jetesës, gjendjen e brendshme, e tjera. Ai e dinte fare mirë se do të shtoheshin problemet ekonomike dhe sociale dhe, rrjedhimisht, se mund të dilnin në sipërfaqe edhe tensione politike, sidomos pas largimit të tij nga skena (nuk ishte në gjendje shëndetësore të mirë qysh atëherë). Kjo dihej edhe këtë.

Por ai dhe shteti shqiptar nuk mund ta

ndryshonin pozicionin as edhe një centimetër. E vetmja gjë që mund të bënin ishte të prisnin derisa bota e jashtme (Lindje dhe Perëndim) të ndryshonte qëndrimin e saj, derisa të ndryshonin kushtet politike objektive në botë. Enver Hoxha nuk mund t'u thoshte kosovarëve nga tribuna e Kongresit: “Ore djema, ulni kokën dhe shtrohuni si bagëti se s'kemi si t'ju ndihmojmë, nuk ja delni dot me kërkesat tuaja, sado të drejta“. Dhe për të gjitha këto u penalizuan Shqipëria dhe shqiptarët. Kjo është mënyra se si interpretohen ngjarjet në botë. Politika është thjesht kalkulim i interesave, konjukturave, dhe i balancës së forcave.

[...]

Ndoshta më mashtron kujtesa, por kam përshtypjen se artikulli me titull: “Pse u përdor dhuna policore në Kosovë?” u botua 7 ditë pas shpërthimit në Prishtinë. Do të thosha se partia dhe shteti shqiptar nuk mund të

reagonin menjëherë, duke dhënë kështu përshtypjen se ishin të përgatitur. Ekzistenca apo jo e divergjencave në udhëheqjen shqiptare ishte natyrisht diçka që preokuponte në atë periudhë edhe të gjitha qarqet e interesuara kudo në botë. Është për t'u habitur si nuk ka pasur deri më sot asnjë informacion publik mbi këtë çështje. Diku duhet të ketë një farë dokumentacioni për këto çështje jashtëzakonisht të rëndësishme; dikush në dijeni të fakteve duhet të ketë hapur gojën pas gjithë këtyre viteve. Mister! Enigmë!!

Për sa i përket vërejtjes suaj: “asnjë reagim zyrtar i Tiranës për gjakosjen e Kosovës në OKB.“. mund të vë në dukje vetëm se OKB-ja nuk ka mandat të merret me çështje të brendshme të një shteti, përveç kësaj, dihet se OKB-ja edhe në atë periudhë dominohej nga fuqitë e mëdha, anëtare të Këshillit të Sigurimit. Dihet edhe se ngjarjet në Prishtinë nuk u pritën aspak me kënaqësi nga asnjë prej këtyre fuqive.

Do të thosha bile se efekti i këtyre ngjarjeve shkaktoi gati një panik të vërtetë në disa qarqe. Ju e dini fare mirë se demonstratat u denoncuan nga pothuajse i gjithë shtypi perëndimor si “manifestime të nacionalizmit, separatizmit dhe irredentizmit shqiptar“.

Kosovarët u denoncuan (pikërisht si thoni edhe ju) si “elementë destabilizues!“ Gjendja ndryshoi vetëm më 1989, në kohën e ngjarjeve të Trepçës, kur nuk ishte më e mundur të mbulohej dielli me shoshë!

ANDI BUSHATI

Pretenca e prokurorëve të Kolumbias për skandalin McGonigal, përtej atyre që dinim, i shërben një debati që e kapërcen fatin e kryeministrit të sotëm shqiptar. Deri më tani ne jemi të bindur se kjo aferë i ka shpërblyer Edi Ramës për të goditur opozitën vendase. Se për të arritur këtë qëllim, ai dhe njerëzit pranë tij, korrupuan agjentin më të lartë të FBI-së në histori, që e ka tradhtuar ndonjëherë këtë institucion. Ne kemi mësuar se në gusht 2017, Charles McGonigal i kërkoi para borxh Agron Nezës, se në shtator ai e solli të takohet me Ramën dhe menjëherë më pas, në një parkim makinash, mori plot 225 mijë USD cash.

Pavarësisht se çfarë thotë propaganda në Tiranë, e përditshmja prestigjioze amerikane 'New York Times' e përmblidhte mirë këtë histori kur konkludonte se agjenti i korrupuar "ndërmori hapa në dobi të politikanit Rama". Këtu diskutimi është i mbyllur. Dhe në këtë pikë leximi i 17 faqeve të prokurorëve të Kolumbias nuk sjell ndonjë gjë të re. As ndonjë detaj që i përforcon pandehmën, si ai që, "FBI nuk ishte e bindur për provat ndaj lobistit të Bashës, Nik Muzin, por ajo e hapi hetimin nën presionin e McGonigal dhe e mbylli menjëherë sapo ky i fundit u largua nga detyra", sërish nuk ndryshon gjë në bindjen e përgjithshme.

Por në të kundërt, aty mes rreshtave, lexohet e zeza mbi të bardhë, një konkluzion që i shërben si një gurë i çmuar debatit tonë të brendshëm. Prokurorët arrijnë në përfundimin se me të marrë paratë, Charles McGonigal, i shërbeu qëllimeve të atyre që e korrupuan dhe jo atyre të SHBA-së. Dhe ky ish agjent arriti që falë pushtetit të tij dhe parave të marra të hapte një hetim kundër opozitës shqiptare. Ky hetim "rrodhi në media" si një shqetësim amerikan për paratë ruse që financonin PD-në. Dhe në Tiranë plasi gurguleja për linçimin



e kundërshtarëve të Ramës, që frymëzohej "nga provat" amerikane.

Edhe njëherë në veshët tanë ushtuan sloganet se aleatit tonë strategjik i duhet besuar qorrazi, se partneriteti me Amerikën është i pacenueshëm, se vërtetësia e fermanëve të perandorisë është e padiskutueshme. Në lojë u shfaqën edhe njëherë të gjithë ata që bëjnë be për SHBA-në edhe kur e shpall Berishën "burrë shteti" edhe kur e etiketon si "minues të demokracisë", edhe kur kërkon stabilitet gjatë qeverisës abuzive të kryeministrit Meta, edhe kur nuk e lë të njëjtin person të demonstrojë si

president me flamur amerikan, ata që i shkojnë me sy mbyllur Amerikës edhe kur Kris Hilli i hap dritën jeshile burgosjes së Fatos Nanos, edhe kur këtë të fundit e presin me nderime në Shtëpi të Bardhë.

Në këtë polemikë, midis atyre që përsërisin me një idiotësi gati religjioze se Amerika nuk gabon, se ajo është e pakorrptueshme, se ajo duhet besuar verbërisht, dhe të tjerëve që këmbëngulin se çdo rast duhet shqyrtuar sipas logjikës, bindjes së brendshme dhe fakteve që kemi në dorë, pa paragjykim ekstreme inferioriteti, konkluzioni i prokurorëve të çështjes

McGonigal vlen shumë. Sepse ai na dëshmon se si një person i korrupuar arriti të shtrembërojë perceptimin tonë për një Amerikë të pagabueshme. Ai arriti t'i imponojë FBI-së një hetim kundër opozitës vendase tek e cila specialistët e saj nuk besonin, përmes tij ky lajm u morr si i vërtetë nga mediat e përtej Atlantikut. Dhe falë të gjitha këtyre së bashku, shqiptarëve iu përcoll një mesazh i korrupuar, që sipas prokurorëve nuk ishte ai që i interesonte SHBA-së, por thjeshtë ai që donin pagatorët e McGonigalit.

Pikërisht për këtë, për faktin se na hap shtëpi që nga perandoria mund të mbër-

rijnë edhe mesazhe të blera me para në dorë, pretenca e fundit është një dokument, që duhet mbajtur mend. Madje ajo është edhe më e rëndësishme sesa debati i ditës për implikimin kryeministrit të radhës me çështjen McGonigal. Sepse fatkeqësisht, ata që kanë speculuar me besimin fanatik ndaj asaj që vjen përtej oqeanit, kanë ekzistuar edhe para Ramës, janë shumëfishuar gjatë mbretërimit të tij dhe do ta vazhdojnë ta bëjnë edhe kundër tij, kur ai të mos jetë më. Prandaj duhet të jemi vigjilentë ndaj atyre që aromën e parave na e shesin si erë të së vërtetës. /Lapsi.al

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT


Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



A është industria e ndërtimit në Tiranë përbaallë një fluske që mund të shpërthejë nga çasti në çast? Kjo pyetje është shtruar shumë herë, kurdo që kanë dalë milionat e metrave katrorë të lejeve të ndërtimit, rritja e pandalshme e çmimeve dhe qerave, apo edhe denoncimet e orgaanizmave ndërkombëtarë për shplarjen e parave përmes kullave të reja.

Në fakt gjithnjë është ngritur një dilemë. Si spjegohet kjo rritje e pandalshme çmimesh deri në 3-4 mijë euro metri², kur shumë apartamente janë bosh. Si arsyetohet kjo thyerje e ligjësisë mes kërkesës dhe ofertës? Pikërisht në këtë drejtim ka investiguar gazetarja ekonomike Ola Xama, në emisionin e saj "Kronos". Duke qenë se nuk ekziston një shifër tjetër zyrtare e banesave që qëndrojnë të pabanuara në kryeqytet, emisioni është rekur të zbulojë numrin e tyre sipas dokumentave të OSHEE. Aty rezultoi se në vitin 2023 janë 51,129

SHIFRAT / A PO SHEMBET PIRAMIDA E NDËRTIMEVE NË TIRANË?



klientë që kanë konsumuar zero energji elektrike. Këto janë vetëm

shifrat e banesave që kanë një kontratë me OSHEE, pa llogaritur ato që

kanë përfunduar por nuk kanë lidhur ende kontratë dhe ato që janë në proces ndërtimi.

Numri i apartamenteve të pabanuara është rritur 3.4 herë gjatë 5-vjeçarit të fundit, nga 14,991 në vitin 2018, në 51,129 në vitin 2023. Ritmi i rritjes së banesave bosh në Tiranë është disa herë më i lartë se kapacitetet me konsum energjie 0 në gjithë vendin, të cilat janë rritur me ritëm normal, 0.87%.

Nga 292 mijë shtëpi që kanë një kontratë me OSHEE në Tiranë, afërsisht 51 mijë nuk janë të banuara. Por pavarësisht ofertës së lartë dhe faktit që një e pesta e shtëpive janë të pabanuara, çmimet e apartamenteve

rriten dhe biznesi gjithnjë e më shumë kërkon investimin në këtë industri, duke mos u shpjeguar dot me asnjë faktor formal të ekonomisë.

Mundësia e vetme që të justifikojë investimin në ndërtim dhe mbajtjen e apartamenteve bosh, janë paratë e pista të krimit të organizuar dhe korrupsionit!

Këtë skanim i ka bërë situatës në emisionin Kronos Ola Xama. Dhe pasi ka bërë këtë radiografi ka ngritur një shqetësim: Nëse vazhdohet me këto rritme a mos po shkodet drejt një fllukse në çmimet e banesave për shkak të rritjes së kapaciteteve bosh me një marzh të pazakontë!

MAL BERISHA

Duket qartë se edhe pas afro dy muajsh që nga ditët e Panairit të Librit 2023 në Tiranë, emri i mirë që bëri libri APOSTULLI i autorit Ilir Ikonomi vazhdon të jehojë tashmë edhe në anën tjetër të Atlantikut dhe pikërisht në New York.

Sigurisht, mjetet e sotme të shumta për shpërndarjen e informacionit, duke përfshirë radio, televizion, gazetatat dhe rrjetet sociale, kanë çdo të drejtë, në opinionin tim, ta cilësojnë këtë libër si një kontribut me vlerë dhe një shtesë inovative në antologjinë biografike të personaliteteve të shquara të kombit tonë. Ky është libri i katërt I botuar nga ky autor, dhe sipas vlerësimit tim, ai sjell vlera të shumta, duke e pasuruar kështu bibliotekën e librave të tillë në vendin tonë.

Në fakt, libri paraqet një rrëfim tërheqës dhe të saktë, duke nxjerrë në pah një paralelizëm mes jetës së Fan Nolit, një klerik i shquar patriot, dhe historisë së organizatës që ai vetë themeloi, Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës, VATRA, së bashku me gazetën shqiptare më të vjetër, "Dielli", e cila vazhdon të botohet edhe sot.

Në veçanti për këtë rast, do të doja të ndaja disa përshtypje nga momenti i përrimit të librit që autori Ilir Ikonomi prezantoi para drejtuesve dhe një numri të konsiderueshëm anëtarësh të Federatës Pan-Shqiptare të Amerikës, VATRA, dhe të Këshillit Shqiptaro-Amerikan në New York.

RETROSPEKTIVË – NË IBRIK TEPE

Në një fjalë të thjeshtë të rastit, pata nderin të ndaja me të pranishmit kënaqësinë e të qenurit një prej shqiptarëve "të paktë" ndoshta, që e kanë vizituar fshatin Ibrik Tepe, vendin e lindjes së Theofan Stilian Nolit. E bashkë me të I paraqita autorit edhe përgëzimet e mia për librin.

Tani, duke lexuar librin "APOSTULLI", më duket sikur në sy më vijnë imazhet e atij fshati ku dikur kishin lëvizur Nolianët, Gjergji, Stiliani, Maria, Sumba, Sullana, Dhimitri,

APOSTULLI I ILIR IKONOMIT NË NEW YORK

xhaxha Tasi, etj.

KRIKAT E LIBRIT

Jam i sigurt se kritikata dhe vlerësimet për këtë libër do të jenë të shumta. Kjo ndodh jo vetëm për shkak të cilësive të veçanta të librit, por gjithashtu edhe për shkak të natyrës shpeshherë kundërthënëse të vetë figurës së Fan Nolit. Në vështrimin tim, ajo që ka bërë autori është de-legjendarizimi, de-heroizimi i tepërt, çmitizimi dhe humanizimi i personazhit të tij, duke e sjellur atë në një nivel më real dhe më tokësor. "Kritika" e mëparshme, veçanërisht ajo me prirje të majta, e idealizon Fan Nolin duke vënë në pah tendencat e tij të majta dhe lidhjen e tij me bolshevikët, pa shqyrtuar ndonjë mangësi të mundshme në personalitetin e tij. Ilir Ikonomi paraqet një "ngerç" të habitshëm midis Nolit klerik, i cili "kungohet" tek Kisha Ruse e cila më vonë bëhet njësoj se në Shqipëri, viktimitë e bolshevizmit.

Unë, si lexues i vëmendshëm dhe simpatizant i Nolit për pjesën e tij të kontributit patriotik dhe letrar në gjuhën shqipe (jo për atë politik në Shqipëri), shoh tek ai një figurë pragmatike, i cili për të mirën e atdheut, ashtu siç e koncepton ai, është i gatshëm të bëjë kompromis me këdo. Teologjia e tij, studimet fetare, përkthimi i lutjeve ortodokse në gjuhën shqipe, ushtrimi i detyrës së priftit, ngjajnë më shumë me Nevojen sesa me Besimin e tij fanatik. Kur them Nevojen, e lidh atë edhe me faktin se ai nuk ishte i "prerë" për punëtor sharrash apo llamarinash, si shumë emigrantë të tjerë të kohës. Në të kundërt ai kishte zgjedhur një jetë intensive intelektuale.

Por kjo zgjedhje nuk i jepte atij mundësinë e një jete normale andaj e gjeti kishën si mjetin e tij të jetesës. Tek kisha ai gjeti instrumentin më efikas për t'i shërbyer kombit duke e tëhuajtur atë pjesë të popullsisë shqiptare të besimit ortodoks (midis tyre edhe ca grekofilë) nga influencat anti – shqiptare të kishës greke dhe duke i tërhequr ata në anën e

lëvizjes patriotike që ai vetë inicioi.

Në fillim të librit, ai paraqitet si një person që nuk i besonte aq shumë fesë. Megjithatë, më vonë bëhet kreu i kishës. Arsyetimi për këtë, sipas interpretimit tim të librit, është se ai ndjente se Kisha Ortodokse e predikuar në gjuhën greke ishte një rrezik i jashtëzakonshëm për ekzistencën e kombit shqiptar.

Por kisha greke kurrë nuk do të kungonte një prift shqiptar – folës që të ngjitej në altar dhe t'i tregonte shqiptarëve se kush ishin në të vërtetë në gjuhën e tyre. Prandaj, duhej një kishë tjetër për t'u shunguruar, dhe u gjet ajo ruse. A ishin rusët caristë miq të Shqipërisë në atë kohë? Jo! Mos të harrojmë se Noli merret me Kishën Ruse më pak se tre dekada pas vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit të vitit 1878, i cili shënon copëtimin e parë të trojeve shqiptare në favor të fqinjëve sllave dhe ortodoks.

Autori, Ikonomi, nuk tenton të na bindë me fjalët e veta për drejtësinë e veprës së Nolit i cili u dorëzua në Kishën Ortodokse Ruse në New York. Ai na jep vetëm faktet. Por fakt është se pa atë ndihmë, ndoshta edhe pse në Amerikë priftërinjtë ortodoks rusë nuk ishin aq të molepsur me politikën anti – shqiptare cariste në Ballkan dhe se, edhe ajo vetë, pra kisha ruse, donte të shkëputej nga Fanari dhe ndikimi grek, gjë që ndoshta e donte edhe për kishat ortodokse të popujve të tjerë me besim ortodoks.

Libri na paraqet përpjekjet e Apostullit, i cili kurrë "nuk u rehatua financiarisht." Në çdo faqe të librit, zbulohet shqetësimi i tij për të mbijetuar në masën që të mund t'i shërbente atdheut dhe kishës. Kjo përpjekje ishte aq e mundimshme por edhe aq fisnike, sa të mund të botonte "Diellin", të ndihmonte në edukimin e shqiptarëve të Amerikës, të ndërtonte Kishën Autoqefale Shqiptare, të themelonte dhe drejtonte Vatrën, të përkthente Sheksipirin, Servantesin, Ibsenin, dhe t'a bënte çështjen shqiptare të njohur në qarqet amerikane, duke luftuar edhe me varfërinë e tij çdo ditë.

Vështrësitë e jetës së tij, Ilir Ikonomi, i paraqet me aq shumë fakte, sa të bën të mendosh se vërtetë vetëm një njeri i tillë, ASKET, që kishte kaq pak pretendime për jetën e tij personale, mund t'i shërbejë atdheut me aq devotshmëri e përkushtim. Ai arrin që ata shqiptarë analfabetë, emigrantë, punëtorë fabrikash, edhe pse në një numër shumë herë më të vogël se ata që jetojnë sot në Amerikë, të kontribuonin edhe financiarisht aq shumë sa të "Jepnin për Nënë" Ky mund të jetë një mësim për shqiptaro-amerikanët, tashmë të rehatuar në këtë vend të lirisë dhe mundësive të pafund.

BISEDË ME VATRANIN IDRIZ LAMAJ

Në një bisedë krejt spontane me vatrarin e njohur Idriz Lamaj, ish-gazetar i Zërit të Amerikës, më tregoi këto ditë se ai e kishte vizituar apartamentin ku ka jetuar Fan Noli në Boston. "Jeta e tij ishte më e thjeshtë se sa mund të bënte një njeri i kategorisë së tij. Por pikërisht në atë apartament janë shkruar dhe nisur letra, dokumente, traktate, madje edhe libra, të cilat kanë pasur një ndikim shumë të madh në çështjen e ekzistencës së shtetit shqiptar dhe në kulturën shqiptare", thotë zoti Lamaj.

AUSTRIAKËT DHE ITALIANËT

Ato që sjell autori në këtë libër – lidhjet e Nolit (dhe të Konicës) me austriakët dhe italianët – na japin një pasqyrë shumë interesante të përpjekjeve të tij për t'u mbështetur tek i vetmi shtet, ose të vetmet shtete, të cilat po e ndihmonin Shqipërinë për pavarësinë dhe shpëtimin nga synimet grabitqare greko-serbe. Megjithatë, ai e kupton se, ashtu si në veprën e Servantesit, Don Kishoti i Mançës, të cilin e ka përkthyer ai vetë në shqip, Shqipëria, e shpëtuara nga Austria dhe Italia, përsuan fatin e Andreas. Episodi i atij djali, të cilin e shpëton Don Kishoti nga duart e disa njerëzve që po e rrihin, por më pas e liron duke

e lënë në rrugë ku ai bie përsëri në duart e tyre për ta rrahur edhe më keq, është identik me atë që edhe Austria edhe Italia bënë me atdheun tonë: ndihmuan për pavarësinë dhe më pas e pushtuan njëra pas tjetrës...!

Aspekti tjetër i përpjekjeve të Nolit për t'a bërë Presidentin Wilson mik të Shqipërisë është një nga pjesët më të bukura të librit.

Ajo që konstatova nga libri, i shkruar kaq bukur, ishte se autori, duke e prezantuar figurën e Apostullit në një rritje graduale, gjithnjë kreshendo, ka arritur që të ruajë portretin e një njeriu që është i afërt me gjenin, i veshur me të gjitha cilësitë e mira, por edhe ato të dobëta njerëzore, pa e idealizuar, lustruar, ose hyjnizuar panevojshëm atë.

NJË KËSHILLË VLLAZNORE

Unë do t'ju sugjeroja që, ashtu siç bënë vatrarin duke sponsorizuar me mbledhje fondesh botimin e "Otellos" dhe shumë veprave të tjera të Nolit, edhe ky libër duhet të financohet nga Vatra për një botim me një tirazh sa më të madh. Pas kësaj, çdo shqiptar patriot, shqiptaro-amerikan, duhet ta lexojë dhe të mësojë se si respektohet ajo që përmendet shpesh me emrin "Kanunorja e Vatrës", zgjedhjet dhe shuarja e konflikteve që shfaqen sot brenda kësaj organizate.

Natyrisht, askush nuk pretendon që të kemi edhe sot një Fan Nol, Faik Konicë, Sotir Peci, Sali Butkë, Bahri Omar, Kristo Fllaq, Petro Nini Luarasi, Kosta Çekrezi, Kristo Dako, Sevasti dhe Parashqevi Qiriazhi, Mehmet Konicë, etj. Megjithatë, mësimet që sjell "APOSTULLI" i Ilir Ikonomit, nuk kanë pse të jenë vetëm stoli, por edhe një mënyrë sesi Vatra mund të rezistojë të mos kthehet në një relike historike, por një realitet efektiv me ndikim në fatet e kombit, si atherë në kohën e Apostullit dhe dishepujve të tij.

LUTFI DERVISHI

KËTA VJEDHIN EDHE PROKURORIN

Ndërkohë që prokurorët specialë janë angazhuar në misionin e shenjtë për të pastruar korridorët, anekset, guzhinën dhe tualetet e politikës shqiptare, një ngjarje e padëgjuar i ndërpreu vrullin e pastrimit dhe kombi mbajti frymën pezull.

Një prokurori special i humbi celularin. Një celular i tipit Iphone nga ata që të rinjtë e sotëm e përdorin edhe për të bërë ndonjë thirrje telefonike.

Të brymosur me doktrinën juridike bashkohore, të armatosur me praktikën e Strasburgut dhe me një etje të pashuar për të vërtetën, prokurorët nuk po e mermin veten nga goditja e madhe: si është e mundur që në shtëpinë e akuzës ku ka vetëm akuzues dhe të akuzuar të ndodhë gjëma, të “avullojë” celulari?

Dhe kur ndodhi gjëma? Në momentin më të mirë, kur besimi i publikut arriti majat e ndërtesës së shtëpisë së drejtësisë.

Një prokuror mund të humbasë një dosje, mund të humbasë edhe mendjen, mund t'i marrin edhe portofolin se njerëz jemi, por si mund të të marrin celularin?!

Reporterët e krimit, këta gjahtarë të paudhësive e mëkateve njerëzore nx-



ituan të hedhin kripë mbi plagën e hapur.

Titujt shpotitës shpërthyen në ekranet e televizioneve.

Raportimet live nga vendngjarja bënë që njerëzit të ndalnin gjerbjen e kafesë dhe të përthithnin çdo fjalë të reporterëve që i referoheshin “burimeve të mia”.

Televizionet në mbrëmje ndërprejnë programet edukative dhe thirrën ushtrinë e ekspertëve për të komentuar “ngjarjen e shekullit”.

Mesa di unë vetë iphone ka një opsion “më gjej” dhe mjafton një kompjuter, ose laptop, ose ipad, ose qoftë edhe një celular dhe kjo çështje zgjidhet nga një ekspert teknologjie.

Po të ishte kjo, do të ishte gjetur ndërkohë - nxitoi të ndërhyjë moderator i cili kishte thirrur në emision katër të ftuar që i binin fyellit në një vrimë.

Në një televizion ku 24 orë në 24 kritikohet opozita për mosqeverisjen e vendit, komentatori i njohur më shumë si avokat me pagesë i qeverisë bëri një ndërhyrje që la pa gojë edhe vetë drejtuesin e pavarur të programit.

“Këtu duhet të kemi parasysh se prokurori po bën një shërbim të madh vendit duke bërë qilizëm në kodrën e abuzimeve, me malin e denoncimeve,... por të nderuar të kemi parasysh se edhe ai që ka mundur t'i marrë iphone prokurorit ka kryer një akt të madh.

Nuk po them të mirë apo të keq se unë nuk jam Papa që lëshon verdikte, por gjesti është i pa precedent. I madh! Madhështor! Pra unë i heq kapelen prokurorit për misionin që ka ndërmarrë dhe i përkulem atij që ka arritur të shqetësojë sadopak njeriun e akuzës.

Nuk kishte ndodhur asnjëherë që dikush brenda një fjalie të ishte edhe me akuzën edhe të akuzuarin, siç i thonë të moçmit, qerratai është edhe me gjuetarin edhe me lepurin.

Ndërkohë që emisionet e mbrëmjes e kthyen iphone e humbur të prokurorit në çështje kombëtare, vetë njerëzit e akuzës, në përputhje të plotë me këshillën e vjetër: “i zoti e nxjerr gomarin nga balta”, u hodhën në veprim.

Brenda 1 minuti morën një letër nga gjykatësja për sekuestrimin e celularit të një gazetari. Gjykatësja i kërkoi ndjesë prokurorit për vonesën prej 60 sekondash.

Celulari i sekuestruar i gazetarit bëri të mundur që prokurorët të gjenin me shpejtësi rrëmbyesin e iphone. Nga komunikimet mes gazetarëve hetuesit e kuptuan se prokurori e kishte humbur celularin gjatë kryerjes së detyrës..

Në një ditë rutinë të prokurorit, gjatë një seance të gjatë pyetjesh me një zyrtar të lartë ky i fundit jo vetëm që kundërshtoi akuzën për vjedhje të fondeve publike, por i shtyrë nga motive të pashpjegueshme arriti t'i marrë iphon-in prokurorit.

Nga komunikimet në celularin e sekuestruar të gazetarit, prokurorit i mbeti në mendje një fjali.. “Këta janë mjeshtra, vjedhin edhe prokurorin”.

KLODIAN TOMORRI

SKENARI HOLLIVUDIAN QË BËRI BASHKË EKONOMINË ME KULTURËN

Shumë nga ata që ndjekin zhvillimet politike mbeten jo pak të çuditur një ditë më parë, kur Edi Rama njoftoi krijimin e një ministrie të re, e cila bashkon ekonominë, kulturën dhe inovacionin në një dikaster të vetëm.

Përtej rrokadës së emrave, largimit të Margaritit dhe afrimit të Blendi Gonxhes në kabinetin qeveritar, habia më e madhe e opinionit qëndron në faktin se çfarë i lidh bashkë ekonominë me kulturën dhe cila është logjika e bashkimit të tyre në një institucion të vetëm.

Kjo nuk është një habi e panatyrshme. Bëhet fjalë për dy sektorë, të cilët në aspektin e politikave dhe administrimit janë aq të largët me njëri tjetrin. Ndaj në historinë e qeverisjes së Shqipërisë moderne, asnjëherë më parë, kultura nuk ka qenë satelit institucional i ekonomisë apo anasjelltas.

Megjithatë strukturat organike të qeverisë nuk janë të ngurta. Në fund të fundit, kabinetet qeveritare formatohen në funksion të filozofisë dhe prioritetve qeverisëse të klasës në pushtet. Dhe filozofia qeverisëse e maxhorancës aktuale ka krijuar një



segment me interesa shumë të mëdha, ku ekonomia dhe kultura piqen me njëra tjetrën. Është administrimi i pronave në vendet historike apo monumentet e kulturës.

Prej disa kohësh në korridorët oligarkike dhe ato të maxhorancës

qarkullojnë zëra për disa projekte të rëndësishme në zona të mbrojtura me statusin e monumenteve kulturore. Porto Palermo dhe Pallati i Brigadave janë dy prej tyre.

E para është një nga zonat më të lak-

muara të Shqipërisë. Një xhevahir në gjerdanin e Rivierës shqiptare, që deri më tani i ka shpëtuar duarve të gjata të oligarkisë apo interesave private të pushtetit pikërisht për shkak të statusit të mbrojtur.

E njëjta gjë vlen edhe për Pallatin e Brigadave. Një kompleks i jashtëzakonshëm historik dhe kulturor, i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 37 hektarësh parku të pyllëzuar. Ky kompleks është një monument prioritar në trashëgiminë kombëtare të Shqipërisë. Por koncesionet çajnë bllokadën, ndërsa orekset financiare formatojnë qeveri.

Si për Porto Palermon ashtu dhe për Pallatin e Brigadave ka plane të përfshirjes së privatëve përmes koncesioneve. Për të parën, verën e kaluar ka patur dhe diskutime para-prake jo institucionale me një biznesmen nga përtej Atlantikut. Ndërsa për dytën, dy vjet më parë, Ministria e Kulturës financoi një draft strategji për menaxhimin afatgjatë.

Në dokumentin strategjik u rekoman-

dua një sistem hibrid menaxhimi me përfshirjen e sektorit privat për të mundësuar financimin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit të Pallatit të Brigadave, ndonëse në formën e Fondacionit jo fitimprurës. Me pak fjalë një sistem i ngjashëm administrimi si ai Butrintit.

Nëse këtyre u shtohet dhe fronti i madh i financimeve që pritet të hapet në sektorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Inteligjencës Artificiale, është e qartë se këtu është krijuar një portofol me interesa gjigande financiare.

Mesa duket Gonxhe është personi i duhur për ta menaxhuar atë dhe për të shtyrë përpara “reformat”. Madje në këta rast fati rezervon edhe një shaka. Në shumë filma aksion të Hollivudit, ka skenarë ku anëtarët e bandave të vjetra, bëhen sërish bashkë pas shumë vitesh për grabitjen e fundit. Rama dhe Gonxhe e kanë nisur bashkë karrierën. Tani u bënë sërish bashkë. Këtë here jo për të mbytur Tiranën e Re./Kapitali

E PARA SHQIPTARE KRYETARE NË NJË BASHKI NË NEW JERSEY, VIOLETA BERISHA: NJERIU MUND TË ARRIJË GJITHÇKA, MBËSHTETJE PËR SHQIPTARËT

Violeta Berisha, e cila së fundmi u betua si kryetare e bashkisë së qytezës Fairview, në shtetin e Nju Xhersit, duke u bërë e para shqiptaro-amerikane dhe gruaja e parë që mban këtë detyrë që nga themelimi i kësaj bashkie, thotë se nuk e kishte menduar kurrë se do të drejtonte një qytet. Familja e saj, me origjinë nga Puka, e la Shqipërinë, për t'i ikur komunizmit, në vitin 1951. Vetë Violeta, lindi në Itali dhe familja e saj emigroi në Shtetet e Bashkuara mbi 50 vjet më parë, kur ajo ishte vetëm 3 muajsh. Në një intervistë për Zërin e Amerikës, ajo rrëfen se si çdo emigrant amerikan kishte ëndrra të mëdha dhe ngjitja e saj në detyrën e kryebashkiakes, dëshmon se mund të arrihet gjithçka.

Berisha, e cila do të drejtojë një bashki prej më shumë se 15 mijë banorësh, i tha koleges Klementina Cenkolari, se në Fairvieë, jeton një komunitet i vogël shqiptaro-amerikan, por zotohet të ndihmojë ata, si dhe shqiptarët që jetojnë në qytetet përreth. Ajo thotë se është krenare që është shqiptare.

Zëri i Amerikës: Zonja Berisha, javën e kaluar ju u betuat si Kryetare e Bashkisë së Fairvieë, duke u bërë e para shqiptaro-amerikane dhe gruaja e parë që mban këtë post të lartë. Çfarë do të thotë kjo për ju, profesionalisht dhe personalisht?

Violeta Berisha: Për mua do të thotë që njeriu mund të arrijë gjithçka që synon. Unë nuk e kisha ëndërruar kurrë se do të drejtoja një qytet. Më parë kisha mbajtur detyrën e këshilltares, që dhe ajo ishte diçka shumë e veçantë për mua. Dhe tani, të jem kryetare, shqiptarja e parë si kryetare bashkie, shqiptarja e dytë si kryebashkiake, por e para në shtetin e Nju Xhersit, kjo është shumë e veçantë.

Zëri i Amerikës: Zonja Berisha, familja juaj ka emigruar në SHBA shumë kohë më parë, kur ju ishit vetëm 3 muajsh. Si ka qenë ky rrugëtim për familjen tuaj dhe për ju vetë?

Violeta Berisha: Si çdo emigrant tjetër që vjen në Amerikë, të gjithë kemi një ëndërr. Nuk e di nëse ëndërra ime ishte të bëhesha kryetare bashkie, por është shumë e veçantë që jam në këtë post. Kjo do të thotë se emigrantët, shqiptarët që vijnë në Amerikë po realizojnë atë që kishin menduar se nuk do të ishte kurrë e mundur. Jam përpjekur të jem pranë njerëzve. Të ndihmoj zhvillimin e qytetit. Është diçka shumë shpërblyese për ne. Më pëlqen kur njerëzit bëjnë mirë. Jam shumë krenare me veten që ndihmoj të tjerët, ndihmoj qytetin. Është një



përvojë e dobishme.

këtë histori sukcesi në jetën tuaj?

Zëri i Amerikës: Kujt ia dedikoni Violeta Berisha: Absolutisht

prindërve dhe fëmijëve të mi. Pa ata, nuk e di ku do të isha. E përmenda këtë dhe gjatë fjalimit që mbajta kur u zgjodha. Ata më kanë ndihmuar për çdo gjë dhe për kapërcimin e çdo pengese që kam hasur në jetë. Dihet se kujt do i ndodhin gjëra të ndryshme gjatë jetës. Dhe po të mos ishin ata, po të mos më kishin nxitur të bëja gjënë e duhur, nuk e di se ku do të isha.

Zëri i Amerikës: T'i kthehemi misionit tuaj si kryetare bashkie. Cilat janë përparësitë tuaja dhe cilat mendoni se mund të jenë sfidat kryesore gjatë mandatit tuaj në këtë detyrë?

Violeta Berisha: Shikoni, ato që shumë njerëz i shohin si sfidë, unë i shoh si mundësi. Unë mendoj se do të jetë një gjë e madhe, vërtet e madhe që të jem në gjendje të ndihmoj qytetin të përparojë, të ndihmoj në qëndrueshmërinë e taksave, në shtimin e vlerës së pronës, në ruajtjen e rendit dhe sigurisë së qytetit. Unë jetoj këtu. Dua ta shoh qytetin tim të begatojë. Në fakt nuk shoh ende aq shumë sfida. Nuk jam e sigurt se me çfarë do të përballem tani. Mendoj se si kudo është fluksi i emigrantëve që vijnë në qytet. Nuk do doja të shihja askënd të lëndohet dhe as t'i ndodhte diçka tjetër. Kështu që, nuk shoh ndonjë sfidë të madhe, madje shpresoj të mos ketë, por dhe nëse do ketë, jam gati t'i përballoj.

Zëri i Amerikës: Zonja Berisha, le të flasim pak për komunitetin shqiptaro-amerikan. Sa është komuniteti shqiptarë aty?

Violeta Berisha: Ne nuk kemi shumë shqiptarë, por ka më shumë në qytetet përreth. Komuniteti shqiptar përbën rreth 10% të popullsisë së qytetit. Jam e gatshme t'i ndihmoj me gjithçka që kanë nevojë, në cilindo prej qyteteve dhe që do të na drejtohen për ndihmë në këtë komunitet. Jam e gatshme t'i ndihmoj me gjithçka që mundem. Ndoshta 200, 300. Nuk jam krejt e sigurt mbi numrin e saktë.

Zëri i Amerikës: Do doja t'ju pyesja gjithashtu në përgjithësi mbi këndvështrimin tuaj për diasporën shqiptare këtu në Shtetet e Bashkuara, veçanërisht, integrimin e saj në shoqërinë amerikane?

Violeta Berisha: Siç e dini, shqiptarët kanë ecur shumë përpara në shoqërinë amerikane. Nuk ka asgjë që ata nuk mund ta bëjnë. Tani shqiptarët janë kryetar bashkie, gjyqtarë, sipërmarrës, pra asgjë nuk është e pamundur për ta. Ndaj jam shumë krenare për ta. Jam shumë krenare të them se jam shqiptare./VOA

Media britanike 'The Times' ka publikuar një artikull për riatdhesimin e shqiptarëve nga Britania, duke cituar dëshmitë e disa prej tyre.

Në artikull përmendet edhe marrëveshja e Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, e cila ka ndihmuar në uljen e numrit të emigrantëve të paligjshëm që kalojnë kanalin, duke theksuar se Britania nuk është vendi i ëndrrave që shumica shohin në TikTok.

Një prej personave i cili ka folur për median britanike është dhe Xhevahir Arusha, një 31-vjeçar elektrikist. Ai tha se nëse do të vendosë të shkojë një herë tjetër në Britani do ta bëjë legalisht.

Artikulli i plotë:

Në agimin e 2 tetorit, Shabani u ul në një varkë të vogël me 50 bashkëqytetarë shqiptarë që po lundronin drejt bregut anglez kur një varkë patrullimi u shfaq përpara tyre. Përpara disa javësh, kamarieri 29-vjeçar ishte i ulur një karrige pas telave me gjemba në aeroportin e Tiranës pas një fluturimi riatdhesimi, dhe 5000 euro borxh.

“Ishte e rrezikshme të gjendeshe në atë varkë dhe nuk do të provoj më. Rrezikova të mbytem dhe tani më duhet t’u kthej të afërmeve të mi paratë që u kam marrë borxh për të shkuar në Mbretërinë e Bashkuar“, tha ai për The Times.

Shaban, i cili nuk pranoi të tregonte mbiemrin e tij, ishte i fundit nga afërsisht 4,600 shqiptarë që mbërritën në Shqipëri nga Britania e Madhe vitin e kaluar, më shumë se dyfishi i totalit të vitit 2022 ndërsa Britania rrit kontrollin në vend dhe përshejtoi dëbimet sipas një marrëveshjeje të nënshkruar me qeverinë shqiptare në dhjetor 2022. Marrëveshja ka ndihmuar në uljen e numrit të shqiptarëve që planifikojnë të largohen, ndërsa numri i emigrantëve që kanë mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar ka shënuar rënie nga 12,000 në 2022 në 953 vitin e kaluar, me një rënie prej 94%.

“Në Britaninë e Madhe, policia hyri në banesën time duke kërkuar një shqiptar tjetër, ai nuk ishte aty, por ata më kontrolluan dokumentet dhe zbuluan se isha i paligjshëm. Unë nuk kam bërë asnjë krim, nëse policia nuk do të vinte për kontroll, do të isha ende atje, por tani jam kthyer këtu dhe u kam borxh njerëzve 6000 euro që i kam marrë hua për të mbërritur në Britani”, tha Genalia Pallimb, 45 vjeç, e cila punoi për 18 muaj në Britani në një lavazh makinash në Dagenham para se të dërgohej në shtëpi. Një prej tyre tha se ata që kthehen në shtëpi ndaluar të largohen për 3 vite nga Shqipëria.

Elektriciisti Xhevahir Arusha, 31 vjeç, nga Tropoja tha se kishte kaluar dy herë në Mbretërinë e Bashkuar dhe në të dyja rastet ishte kthyer, së fundmi përpara

SHQIPTARËT E RIATDHE SUAR NGA BRITANIA E MADHE: HERËN TJETËR DO TË SHKOJMË LIGJËRISHT



dy muajsh.

“Më ndaluan në Walthamstow, mua edhe një shokun tim për një kontroll tekta po udhëtonim. Nëse kthehem, herën tjetër do ta bëj legalisht”, tha ai. Alastair King-Smith, ambasadori britanik në Shqipëri, tha se emigrantët e dërguar në shtëpi u kanë treguar personave të tjerë që duan të ikin për në Britani që të mos besojnë çdo gjë që postohet në TikTok.

“Njerëzit që kthehen në Shqipëri po raportojnë se përvoja e tyre nuk ishte ajo që u reklamuan nga kontrabandistët në mediat sociale”, tha ai për Times.

34 emigrantët të paligjshëm dhe 28 shqiptarë të dëbuar pasi u burgosën për kultivim kanabisi, dy për shitje droge, një për falsifikim dokumentesh dhe një për drejtim të rrezikshëm, u deportuan në Shqipëri në dhjetor.

Falë marrëveshjes Mbretëri e

Bashkuar-Shqipëri, numri i të dënuarve që janë deportuar është rritur, pasi shqiptarët aktualë në burgjet britanike, rreth 1,250 do të dërgohen së shpejti në atdhe për të përfunduar dënimet e tyre. Riatdhesimet nuk janë i vetmi faktor që pengon nisjet, policia britanike dhe ajo shqiptare tani po ndajnë të dhëna për të gjurmuar trafikantët. Qeveria britanike po punon gjithashtu me TikTok për të hequr reklamat nga trafikantët, duke përfshirë një reklamë përpara Krishtlindjeve që ofronte “marrëveshje me çmime të reduktuara të sezonit festiv” për lundrimet.

Zyrtarët pranojnë se një pjesë e rënies së migracionit mund të jetë edhe për shkak të fermave të kanabisit në Mbretërinë e Bashkuar me personel të plotë, ose sepse thjesht ka më pak të rinj shqiptarë që kanë mbetur në veri të vendit. Ata gjithashtu e dinë se shumë nga ata që kanë mbetur në qytete si Kukësi pranë kufirit me

Kosovën janë ende të vendosur të largohen.

Një përgjigje ka qenë krijimi i më shumë kanaleve ligjore për të mbërritur në Mbretërinë e Bashkuar, me qeverinë britanike duke hapur një zyrë vizash në Kukës. Një zgjidhje tjetër është t’u jepni njerëzve një arsye për të mos u larguar. Për ta arritur këtë, Britania e Madhe miratoi 8.3 milionë paund për projekte duke përfshirë financimin e 20 bursave të arsimit të lartë dhe 50 grante biznesi, ndërkohë që Këshilli Britanik po mbështet mësimet e mendimit kritik dhe kodimit kompjuterik në shkollat lokale.

Zyrtarët thonë se qëllimi është që të rinjtë të mendojnë për kurset deri në moshën 13-vjeçare, moshë që ata fillojnë të shohin videot e TikTok të një jete ëndrrash në Mbretëri të Bashkuar. Ironia është se pas luftës së emigracionit të paligjshëm në Britani për të

kufizuar dëmin e fuqisë punëtore të Shqipërisë, kërcënimi tjetër i madh do të jetë migrimi i ligjshëm në Gjermani pasi Berlino lehtësoi kontrollin e migracionit në një përpjekje urgjente për të joshur më shumë shqiptarë për të punuar në fabrikat e vendit.

“Është problem. Fatmirësisht ne kemi shumë filipinas, pakistanezë dhe indianë që vijnë”, tha Ministri i Brendshëm Balla.

I ulur në një kafene në Tiranë, një shqiptar tha se ishte i vendosur të qëndronte në atdhe pas kthimit nga Britania e Madhe në vitin 2022.

“Shkova sepse doja të bëhesha hero për familjen time dhe të siguroja ushqim për familjen. U ktheva sepse nuk dua të jetoj m frikë dhe dua të jem i rregullt”, tha Fatlum Cahame, 29 vjeç, i cili jetonte në Shepherd’s Bush dhe punonte në ndërtim, por u kthye vullnetarisht dhe tani ka hapur një linjë veshjesh.

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni
regjistruar në
Google?!

**Për çdo
konsultim
mund te vini
në zyrat tona**

The **Albanian**

**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**

Na kontaktoni:

**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**



**NE MUND T'U
NDIHMOMJME EDHE ME:**

- Business Cards
- Logos
- Invoices
- Posters
- Quotations
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing
- Etc

ENTON ABILEKAJ

Në 10 janar 2024 Edi Rama i dha vetes një tjetër të drejtë që ia mori opozitës, ta bëjë Kodin Zgjedhor vetëm. Konferenca e shtypit nga Shëngjini, ku u shpall ky vendim, ndodhi dje, por raportimi nuk mund të bëhet më pa data. Janë momentet historike të rikthimit në diktaturë prandaj çdo vendim që i shërben, duhet të ketë datën.

Ndodhi në 2017, që, në marrëveshje me Lulzim Bashën, pas 5 orësh bisedime jotransparente, të bëheshin zgjedhjet në një afat më të shkurtër se 40 ditët që Kodi Zgjedhor kërkonte për regjistrimin e Koalicioneve. Pasoja ishte që Edi Rama, për herë të parë fitoi pa aleatë, vetëm 1 vit pas kanabizimit të plotë të vendit. Ishte 17 maj 2017, kur Lulzim Basha me shtrëngimin e dorës përpara kryesisë së Kuvendit, i hapi rrugën Edi Ramës për të ndërtuar pushtetin personal.

Ndodhi në shkurt të 2019 kur opozita dorëzoi mandatet, për të lënë një parlament njëpartiak dhe për ta shtuar pushtetin personal të Edi Ramës. Dukej sikur Lulzim Basha kishte marrë vendimin të mos ndiqte më farsën institucionale të një pushteti që ishte kapur në përgjime, duke vjedhur zgjedhjet, duke mohuar të drejtën bazë që një vend të quhet demokratik. U duk sikur opozita do të bashkohej me qytetarët për të rikthyer votën e lirë, si parakusht për zgjedhjet e ardhshme. Ishte 16 shkurt 2019, kur Edi Ramës iu dorëzua pushteti legjislativ.

MONIKA STAFA

Kur sapo kishte hapur një faqe të saj në rrjetet sociale, ndoshta për të shtyrë kohën a ndoshta për t'i dhënë ca ngjyra jetës vetmitare, në atë fshat të vogël pranë Durrësit, e akuzuan për një 'krim' a sjellje të pamoralshme që nuk e kish kryer. Një vit më vonë historia rrodhi ndryshe. Këtë herë 'krimi' kish ndodhur. Bedrie Loka kish kryer vetëvrasje.

Nuk e dimë cilat kanë qenë arsyet e vërteta të vdekjes së saj. Nëse do ta meritonte apo jo të vdiste ashtu. Nuk e dimë nëse gjërat mund edhe të kishin shkuar ndryshe atë natë. Ashtu si nuk besoj se do të mësojmë diçka më shumë për të në ditët në vazhdim... Por ajo që dimë me siguri është që asnjë prej nesh nuk mund të gjykojë të drejtën e saj për atë thirrje të fundme që i bëri botës.

Në mbrojtje të dinjitetit të vet.

I vëllai tregoi se ishte martuar shumë e re. Prindërit e patën dorëzuar tek një njeri që për të, do të ishte dashuria e parë. Dhe si të gjithë thonë, ti nuk mund ta harrosh kurrë dashurinë tënde të parë. Sepse me dashurinë e parë në mendje, nuk ke asnjë të kaluar. Nuk ke njeri tjetër për të kuj-

Ndodhi në qershor të 2019, kur i njëjti Lulzim Basha, bojkotoi zgjedhjet vendore, për t'i hapur rrugën një pushteti njëpartiak lokal. Ende dukej sikur rruga e bashkimit me qytetarët po bëhej e pashmangshme, ndërkohë që PD po dorëzonte çdo pushtet tek Edi Rama. Dukej sikur aleanca e qytetarëve me opozitën do të përplasej me pushtetin e uzurpuar nga një njeri, edhe pse kishte mbështetjen perëndimore. Por, pas zgjedhjeve lokale, lideri i opozitës u zhduk, për t'u shfaqur disa muaj më vonë, për t'u ulur me Damian Gjinkurin në tryezën e reformës zgjedhore. Ishte 30 qershor 2019 kur Edi Rama mori në dorë gjithë pushtetin lokal.

Ndodhi në 2020, që pasi bëri disa ndryshime konsensuale, të diktuar nga SHBA dhe BE, në Kodin Zgjedhor, Edi Rama e prishi marrëveshjen duke prishur koalicionet me ligj. Ai ishte një hap i rëndësishëm për instalimin e pushtetit personal, pasojat e të cilit po i vuan opozita sot. Ishte 30 korrik 2020, kur marionetat e Edi Ramës dhe mbetjet e opozitës votuan kundër barazisë në zgjedhje.

Ndodhi në 2021, që rezultati i zgjedhjeve të përcaktohej nga blerja masive e votës, në një operacion special të partisë në pushtet në bashkëpunim me policinë, kriminelët më të njohur dhe biznesmenët më të mëdhenj. Edi Rama fitoi mandatin e tretë. Përballë një opozite që në vend të pushtonte



institucionet pas manipulimit, zgjodhi farsën e dorëzimit të fakteve në zyrat e manipulimit, kishte mbështetjen e pashpjegueshme të SHBA dhe BE, ndërkohë që raportet e vëzhguesve perëndimorë vlerësuan se partia -shtet përdori çdo mjet, edhe blerjen e votave. Ishte 25 prill 2021 kur Edi Rama fitoi i vetëm për herë të dytë pasi kishte shpallur ambicien për të qeverisur jo më pak se 16 vjet.

Ndodhi në maj - shtator 2021, më pak se 1 muaj pas zgjedhjeve, kur, në vend të tentonin kufizimin e pushtetit të Edi Ramës, SHBA-të i dhanë një goditje opozitës. Lideri historik i PD-së u sh-

pall non grata, ndërsa liderit në detyrë iu kërkua përjashtimi i tij. Në vend që të përqëndrohej te reagimi pas vjedhjes së zgjedhjeve, opozita u përqëndrua në sherrin brenda vetes. Kryetari në detyrë vendosi të përjashtojë Sali Berishën, duke i hapur rrugën përçarjes përfundimtare të partisë më të madhe të opozitës. Ishte 9 shtator 2021, kur Lulzim Basha, për të disatën herë, dha një dorë në instalimin e pushtetit personal të Edi Ramës.

Data të tjera para, ndërmjet apo pas këtyre mund të ketë. Të gjitha shenjojnë momentet historike të kalimit nga një shtet kaotik-demokratik, në një

shtet personal, autokratik që po bëhet çdo ditë e më shumë totalitar.

Nuk janë vetëm datat, janë edhe njerëzit që e mbështesin që duhet të shenjojnë, për të mos u harruar këtë herë, për të mos përsëritur të njëjtin faj, për të mos e zhytur edhe një herë vendin në errësirën ku po zhytet me shpejtësi.

Nëse një ditë do të dalë nga errësira. Sot është 11 janar, 78 vjet nga dita kur Enver Hoxha e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore, pasi fitoi zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, nën akuza për manipulime.

është arsyeja pse ne duhet të jetojmë si një tufë e pandalshme që lufton për mbijetesën e saj.

Bedria ishte njëra prej tufës.

Shpesh herë njerëzit mendojnë se të kapësh një mundësi është si të kapësh një tren në ikje. Ai vjen vetëm një herë në stacion dhe nëse e humbet a jo, kjo varet nga fati juaj.

Unë nuk jam i të njëjtit mendim. Sepse i besoj të gjitha mundësitë rreth nesh. Fati i vërtetë është të dish t'i njohësh mundësitë dhe të mos i lësh të shkojnë dem. Por për këtë duhet guxim. Guxim për të vrarë frikën. Dhe për të ecur para. Për të ecur para që të vazhdojmë të luftojmë deri në fund. Edhe nëse kjo do të thotë të rrezikoni jetën tuaj ose të përballeni me të gjithë. Edhe atëherë kur nuk e dini nëse do t'ia dilni.

Sepse motivi i së vërtetës brenda jush është sinonim i lumturisë. Arsyeja përse është e rëndësishme ta shijojmë atë. Edhe pse nuk e dimë kurrë sesa do të zgjasë.

Gjithmonë do të jetë dikush aty që do t'ju tregojë se asgjë nuk është plotësisht në duart tuaja. Dhe kjo jetë të jep vetëm mundësi të reja ndonjëherë...

Jetë ose vdekje. Shpresë apo dëshpërim.

BEDRIA DHE KURBETI



tuar. Jeni vetëm ju të dy. Por ndodh ndonjëherë që koha e korrupton atë dashuri duke e bërë të tregojë anën më të keqe të saj, xhelozinë.

Çfarë ndodhi?

Ishte 2 janar. Burri ishte kthyer prej kurbetit të lodhshëm. Duket pa frutet e nevojshme të kënaqësisë që të jep një punë që e do. Pa mallin e ëmbël

për të dashurit që do. Pa gëzimin e dritës në familjen që shkon.

Prej rrefimit mësuam se nga mbrëmja atypari fëmijët kishin kaluar orë tensioni, ato netë të Vitit të Ri. Bashkë, aty të mbledhur prej pasigurisë dhe llahtarisë që ushqen si zjarri, distanca e kurbetit. Dhe si në cdo rrefim bibliik është gruaja, gjithmonë ajo, e para me instiktin e gjallë të një dhimbje të

pashpjegueshme e therëse që zien nga mendimet të clirojë fëmijët e saj prej orëve dëshpëruese të gjykimit.

Dhe Bedria mendoi. Mendoi si Bibla e ka shenjtëruar duke bërë theror jetën e saj. Me vetëvrasjen e saj.

...

Xhelozia është një ndjenjë që shoqëron njeriun gjithë jetën. Me kohë ajo zbutet derisa venitet por kur ajo të pushton pa kontroll bën të themi gjëra që nuk i ndejmë realisht. Xhelozia nxit sjellje që nuk do t'i kishte besuar kurrë se do t'i bëje më parë. Xhelozia mund edhe të vrasë. Ndaj nuk duhet lejuar që ajo të egërsojë me zemërim dhe inat ndjenjat tuaja. Me urrejtje gjithashtu. Kjo është e vetmja mënyrë për të njohur dashurinë e vërtetë dhe që të mund ta jetosh atë, pa paragjykim.

Ne lindim vetëm dhe vdesim po aq vetëm. Por duhet ta dimë se e izoluar qenia njerëzore është thellësisht e dobët. Dhimbja, frika, pasiguria... rriten kur njeriu është vetëm. Kjo

ENVER ROBELLI

Gjurmëve të aktorit shqiptar në Arosa

1.

Kush shkon sot në Arosa, në njërin nga qendrat më të bukura të skijimit në Alpet e Zvicrës, mund të dëgjojë skiatorë duke i dhënë kurajë njërit-tjetrit në pistat e gjata. Natyrisht në gjuhën shqipe! Kush shkon sot në Arosa mund të kalojë pranë një strehimoreje arinjsh; ata s'flasin shqip, por aty kanë gjetur strehë dy arinj nga Shkodra, të cilët i ka sjellë nga Veriu i Shqipërisë një shoqatë zvicerane për mbrojtjen e kafshëve. Kush shkon sot në Arosa, mund ta bëjë këtë me një sebeb krejt tjetër. Të ngjitet stitigjeve malore, të mbuluara me borë dhe të reflektojë. Për shembull: për vitin 1916. Është viti kur këtu arriti një aktor me origjinë shqiptare, tërësisht i deziluzionuar.

2.

“Para meje, pas meje, krahas meje kufoma gjysmë të djegur, s’dua t’i përshkruaj më imtësisht se si dukeshin, vetëm dua të të them se nuk kam ngrënë asgjë dhe kur uria më detyronte të merrja një kafshatë: sapo e kapërdija, më kthehej. Me gjasë kurrë nuk do ta heq nga hunda këtë erë, ajo më ndjek pa pushim”. Këtë letër aktori Aleksandër Moisiu ia dërgoi më 26 maj 1915 të dashurës dhe gruas së tij të mëvonshme Johanna Terwin. Moisiu në atë kohë ndihej gjerman, më saktë prusian dhe vullnetarisht ishte angazhuar në ushtrinë gjermane. Mund të ndihej shqiptar (për shkak të të atit), italian (për shkak të nënës), austro-hungarez (për shkak se qyteti i tij i lindjes, Trieste, i përkiste Perandorisë Austro-Hungareze).

ALEKSANDËR MOISIU NË ALPET E ZVICRËS



Po atë vit, më 6 shtator 1915, Moisiu ishte pjesë e një ekuipazhi që po trajnohej me avion në Francën veriore. Befas krahët e avionit u goditën nga plumbat e mitralozit dhe piloti që i shtyrë të aterronte me urgjencë. Në tokë Moisiun e pritën ushtarët anglezë. E arrestuan! Pastaj Moisiu dhe shokët e tij u mbajtën në një kamp francez. Në përpjekje për të ikur nga burgu, ai u infektua me tuberkuloz. Një mision mjekësh zviceranë propozoi internimin e tij në Zvicrën neutrale. Kështu Moisiu arriti në qershor të vitit 1916 në fshatin e bukur alpin Arosa. Udhëtimin e tij në Arosa shtypi i kohës e përcolli hap pas hapi. Më datën 3 qershor gazeta “Vossische Zeitung” shkroi: “Me 25 të internuar të sëmurë gjermanë lejtënantit i avionit Aleksandër Moisiu kaloi Gjenevën”. “Tash jam në një truall mik”, i shkroi Moisiu nënës së tij. Arosa ishte qendër e njohur për trajtimin e njerëzve që vuanin nga problemet me mushkëri. Kur Moisiu arriti në Arosa, pacientët e pritën me lule

dhe duartrokitje.

3.

Ndonëse i internuar i luftës, Moisiu sapo e mori pak veten, nisi të luante teatër. Nuk kishte më iluzione të mëdha, nuk dëshironte të kthehej në luftë, dëshironte të ishte më pak gjerman e më shumë socialist. Drejtori i Teatrit të Zürichut ia siguroi një leje pune dhe Moisiu në sezonin 1916/17 luajti në skenën e Zürichut disa role, mes tyre Hamletin. Luajti edhe në teatrot e Bernës, Luzernit dhe Schaffhausen-it.

Bashkë me Moisiun, afro 40-vjeçar, në skenën e Zürichut luante Elisabeth Berger, një vajzë afër të njëzetave. Moisiu u dashurua. Dhe sipas biografëve të Moisiut, Elisabeth Berger është e vetmja grua që e refuzoi. Nuk bënë punë letrat e tij të zjarrta, buqetat me lule, telegramet, telefonatat. Citat nga një letër që Moisiu ia dërgonte Berger-it: “Edhe një herë mora penën dhe po të them: trup

e shpirt i kam të sëmurë, shumë, shumë të sëmurë. Ndiej neveri të madhe. Me kokë të mpirë, shpirt të sfilutur, i vyshkur, i thyer, pa besim, pa pasion kryej punën time, që mos t’i hidhëroj njerëzit që varen prej meje. Zhgënjimi im mbi tradhëtinë tënde është i pakufishëm, kënga ime mbeti e pakënduar. (...) Mbyll fort sytë dhe s’dua t’i shoh kurrë sytë. Opiumi, morfiumi, veronali më ndihmojnë dhe ngushëllojnë. Asgjësoji letrat e mia dhe kujdesu që kurrë më mos të të shoh derisa të jem gjallë. Shpresoj që fati të ketë mëshirë ndaj teje dhe të të kursejë nga vuajtjet që m’i shkaktove”. Dramë e madhe! Më 1919 Moisiu u martua me Johanna Terwin. Një vit më parë ishte ndarë nga gruaja e tij Maria Urfus. Në Arosa Moisiu do të kthehej shpesh. Ajri alpin e kishte kthyer në jetë dhe në skenë.

4.

Në shtator të vitit 1917 Moisiu u lirua nga internimi në Arosa. Kritiku i njohur i teatrit Alfred Polgar njoftoi publikun gjerman mbi rolin e Moisiut si Romeo në Vjenë (në Volksbühne): “Aleksandër Moisiu po luan sërish teatër. Askush nuk luan në mënyrë aq intensive sa ai, askush s’e ka këtë afsh të tipareve të bukura, askush nuk është aq i adhuruar (...) i dashuruar në fantazinë e skenës”. Mes viteve 1918-1933 Moisiu pushtoi skenat teatrore në Skandinavi, në Zvicër, në Holandë, në Çekoslovaki, në Poloni, në Hungari, në Rumani. Më 1929 luajti në teatrin gjerman në Buenos Aires. Dhe në fund u kthye në Zvicër. Sipas porosisë së tij u varros më 1935 në një fshat pranë liqenit të Luganos në Zvicrën italiane. Vjena, qyteti ku vdiq më 22 mars 1935, tre vjet më vonë u “in-

tegrua” në Gjermaninë naziste. Bota pastaj do të merrte flakë. Dhe flakët e saj ai i kishte parë pak vjet para së të vdiste. Nazistët e urrenin. Ai ishte i huaj për “botën e pastër ariane” të ithtarëve të Adolf Hitlerit. Ai ishte kundërshtar i nazistëve, madje i orëve të para. Më 13 nëntor 1919, Moisiu foli para 1200 personalitetëve gjermane të cilat ishin tubuar në sallën e Parlamentit në Berlin për të kujtuar politikanin socialdemokrat Hugo Haase, të vrarë nga një person me të meta mendore. Atëbotë Moisiu ishte socialist. Për këtë arsye autoritetet çekoslovakë ia ndaluan hyrjen, por presidenti ia lejoi. Më 1 maj 1919 Moisiu mbajti fjalim edhe para punëtorëve të Zürichut.

5.

Në maj të vitit 2003 në rivierën e Francës jugore vdiq në shtëpinë e saj Sonja Wiberg. Ajo ishte aktore dhe valltare e njohur. Në gjësendet që la pas u gjend një letër. E dërguar nga San Remo në mars të vitit 1935. Dërguesi i letrës: Aleksandër Moisiu. Moisiu i shkruante Sonja Wibergut: “Mirë, e dashur, më bli 1 ose 2 kravatë nëse të pëlqejnë për kostumin e kaltër dhe bojëkafë dhe sidomos për raste të veçanta... Të uth dhe gëzohem aq shumë!! Aleksandri”. Pastaj ai i dërgoi lule Sonja Wibergut dhe këtë shënim: “Pak lule të kam dërguar”. Sonja Wiberg ishte e dashura e fundit e Moisiut. U njohën më 1931 në Salzburg, ai 51-vjeçar, ajo 19-vjeçare. “Menjëherë ramë në dashuri, nga distanca prej 40 metrash”, ia ka treguar Wiberg një publicisti gjerman. Në qafë ajo mbante një qafore argjendi, të cilën ia kishte blerë Moisiu. Më 1931. Në Venecia.

- Kujtohet për të kuptuar se si jemi haruar -

VISAR ZHITI

Ishte datëlindja e Fan Nolit dje, atij që ka hyrë në Historinë moderne të Shqipërisë duke e lëvizur atë histori, duke i shprishur datat e saj, si deputet, si rebel, si kryeministër, është themelues i Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare, guxoi si askush, “Apostull”, do të quhej në një libër të ri, të porsa dalë në Tiranë, është mërgimtari mahnitës, plot kulturë e dije, që themelon në SHBA shoqata e gazeta e shkon deri të Presidenti për “çështjen shqiptare”, është pjesë e ndjeshme e kulturës së re shqiptare si orator, poet e përkthyes brilant, është... e çfarë s’është, veprimtar dhe ndërgjegje, kalorës skënderbejan e shkatërrues, arritës, furi, kryq dhe udhëkryq, u shkon gjërave deri në fund, pa mbaruar asnjërin, i madh dhe në gabime, baladesk, triumfator i mospërmushjeve, gjeni i dështimeve, vigan po prej tyre, ëndërr dhe përvojë dhe kujtesë...

LËVIZJET ME NOL...

Dje kishte datëlindjen?

1.

E kujtoi qeveria? Se si kryeministër Noli është frikshëmrisht i padobishëm, nuk bëri reformat që premtoi dhe si i majtë, solli ambasadën sovjetike në Tiranë, të parën në Ballkan, çoriditës.

2.

Po Kisha Autoqefale Ortodokse Shqiptare u kujtua për Imzot Nolin - themeluesin e saj? Që guxoi rrezikshëmrisht me patriotizëm? Atë që ai donte të ndalte, pikërisht ndikimi grek ka përparim të ndjeshëm dhe me cënime të rënda në mëvetësinë e saj.

3.

Po Noli shkrimtar, përkthyes, muzikant a u kujtua? Shqipëria që ai la, tani nuk ka fare institucion të shkrimtarëve dhe artistëve, mendimi i atyre që kanë mbetur nga Realizmi Socialist nuk e kalon lartësinë e shtatorës së rrëzuar të diktatorit Hoxha dhe ka thellësinë e gropave septike në

shtëpitë e tyre, do të thoshte mbase Noli vetë.

4.

Po diaspora shqiptare në SHBA, ku ai themeloi “Vatrën” e saj dhe gazetën e saj “Dielli”, ku jetoi si lider shpirtëror, na la kishën dhe ka varrin, që duan t’ja shpërngulin në Shqipëri, gabim tjetër ky, që do t’u ngjante veprimeve të çrrënjësive të punëve të tij të vlefshme.

Natyrisht që “Dielli” shkruajti dhe vatrën në Boston çuan lule te vendi i shenjtë, ku prehet Noli. Po meshë? Përkujtimore? Po që e kujtonin në fb njerëz plot...

Në Nju Jork tani ka një rrugë me emrin e Nolit, një metaforë e ecjes së tij, e kahut të ri, nga SHBA - aleate jetike e dy Shqipërive në Ballkan dhe e gjithë shqiptarëve kudo.

Para Paramentit në Tiranë është një shtatore e Fan Nolit, që nuk mëton t’i ngjajë atij, por mendimit dhe bëmave të tij ose më saktë si mund të shihen ato, të forta dhe vrazhdë deri në një si

grotesk të qetë, etj, etj. Po e madhërishtja? E pambërritshmja? Gjeneriteti?

Shqiptarët, jo vetëm të Amerikës, por sidomos ata, grupet dhe shoqatat e tyre, kisha, akademitë, katedrat deri dhe çdo student shqiptar, kanë se ç’mësojnë nga Noli, nga vullneti i tij për dije dhe përkushtimi, nga zemërimi i tij dhe guximi, nga atdhedashuria, nga fjala dhe muzika, nga miqësia dhe bashkëpunimi me korifeun tjetër, Faik Konica, nga veprimet e tyre, vlera që shkëlqejnë si gurë të çmuar, edhe kur s’janë të gdhendura përsosmërisht...

5.

Noli do të ketë dhe datëlindje nesër. Ç’do të përgatitet të thuhet për të? Ndërkaq simboli i Nolit më duket si një figurë shahu në skakierën e realitetëve shqiptarë, me ato kutitë e fatit bardhë-e-zi dhe siç thuhet në këtë lojë, ja, u bë një lëvizje me oficer (komplotet ushtarake) apo me ushtar

(sa janë vlarë, jo vetëm në luftë), luajta torrën, çoje atje (po rrënohen kështjellat tona), hidhe kalin (të Skënderbeut?), mbretëreshën kujdes, (sa mbretëreshë të bukur kishte Shqipëria!), lëviz mbretin patjetër, sekretarin e parë, presidentët, etj, etj, por po një lëvizje me Nol a do të duhej? Dhe si do të mund ta bënte Shqipëria? Ai është i shumë mundësive, i sfidave joshëse si humnerat dhe si majat e maleve me borë, si përvojë dua të them, ku fryn ashtu si simfonitë bethoveniane...

Pres me dëshirë dhe me një si anktë që ç’Nol do të na sjellë në vazhdim autori i veprës së re për të, “Apostulli”, historiani i shkëlqyer Ilir Ikonomi? Se Noli mbetet dhe poeti tribun me një tragjizëm shekspirian, hokatar i trishtë si ajo që solli nga Servantesi, i dalldisur si një Khajam, që donte që ai të bëhej Shqipëria dhe mbeti i copëzuar ndër shqiptarë, vezullueshëm, si ata dhe ai, por ca më lart, olimpik, gjithë vetëtima dhe me brerore, që dhe kur s’e kujtojmë, kujtohemi se kush jemi dhe si jemi haruar...

SI TË BËHEN EVROPIANËT EVROPIANË

VETON SURROI

Gogoli Donald Trump sërish ngre dilema rreth Amerikës në Evropë

1.

Një vajzë kosovare shkoi para disa vjetësh në SHBA për të përfunduar vitin e fundit të shkollës së mesme dhe përvoja më e madhe për të ishte se u kthye si evropiane.

Në vetëpërceptimin e saj, e rritur me përsëritjen e njëpasnjëshme se “Kosova do të hyjë në Evropë”, Kosova ishte një territor që disi ishte në kontinentin evropian (si pjesë e diçkaje që quhet Ballkan) por një ditë do të ishte Evropë.

Në shkollën e saj amerikane, ku shumica dërrmuese ishin ose emigrantë, ose bij a nipër emigrantësh koreanë e brazilianë, meksikanë e nigerianë, italianë e irlandezë, ishte gjithsesi më lehtë e kuptueshme për shokët e klasës ta klasifikonin si evropiane, në vend të rrëfimit të ndërlikuar të saj.

Dhe, si e këtillë u kthye në Kosovë, si evropiane.

2.

Një analogji mund të tërhiqet në atë që është duke i ndodhur këto ditë ligjërit publik të shumë vendeve të BE-së. Evropianët e ndryshëm - francezë e irlandezë, spanjollë e estonezë, pra ata që duke qenë në BE nuk kanë dualitet interpretimi të identitetit të vet evropian siç kishte vajza kosovare - po mendojnë, shkruajnë dhe flasin se si duhet të jenë përgjegjës për kontinentin e vet, pra të jenë evropianë.

Shtytësi më i madh mund të jetë sot Donald Trump dhe mundësia e tij e rikthimit si president. I tërë kontinenti evropian (me përjashtim të disa enklavave autoritare) ishte në ankth nga paparashikueshmëria e veprimeve të këtij njeriu sa ishte presidenti amerikan. Tash, në analiza javë për javë shtrohet pyetja e pranisë amerikane në NATO me gogolin Donald Trump në mandat të dytë presidencial. Dhe mjafton të bëhet qoftë edhe si spekulim i largët mundësia e largimit të SHBA nga NATO që të ndihet pasiguria kolektive: NATO është themeluar si aleancë nga SHBA jo vetëm për ta mbrojtur Evropën nga Bashkimi Sovjetik (gjegjesisht Rusia e sotme), por edhe për të mos lejuar që evropianët të shkojnë në luftë kundër njëri-tjetrit, një traditë deri atëherë qindravjeçare. Pa Amerikën, Evropa nuk mbetet vetëm pa shtyllën e nevojshme të mbrojtjes, por edhe pa aleatin, prania e të cilit ka ndërtuar besimin e evropianëve në njëri-tjetrin. Si do t'i bëhej pa këtë instrument besimi



ndërevropian?

Por janë njëra pas tjetres luftërat e mëdha dhe ato potenciale që do t'i shtojnë evropianët të kërkojnë a pranojnë të jenë më evropianë. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës, tashmë një shteti kandidat për anëtarësim në Bashkim Evropian, shtron pyetjen thelbësore: çka do të bëhej me këtë shtet po të mos ishin reagimet prijatë të SHBA dhe Britanisë së Madhe për të ndihmuar mbrojtjen e këtij vendi? Apo çka do të ndodhte nëse për një arsye (siç mund të jetë politika e brendshme amerikane, pra zgjedhjet presidenciale) ndihma ushtarake për Ukrainën të paralizohej apo dobësohej? Nëse ardhmëria e Ukrainës është në BE, a nuk duhet ta sigurojnë këtë ardhmëri edhe ushtarakisht vendet anëtare të BE-së?

Lufta e Izraelit në Gaza është shembulli tjetër. Bashkësia transatlantike ka qenë njëzëri për të drejtën e Izraelit për mbrojtje pas pogromit të Hamasit kundër hebrenjve në Izrael (dhe po e përshkruaj kështu, sepse ishte një operacion ushtarak i Hamasit drejtuar çdo fëmije, gruaje apo burri hebraik që do t'u dilte përpara). Megjithatë, bashkësia transatlantike nuk mund të jetë e njëzëshme kur Izraeli në Gaza po zhvillon një luftë të ndëshkimit kolektiv, zhvilluar kundër çdo fëmije, gruaje dhe burri palestinez.

Një Evropë e ndërtuar pas gjenocidit të Luftës së Dytë Botërore nuk mund ta përkrahë barazimin e të drejtës

legjitime të Izraelit për t'u mbrojtur me mohimin e të drejtës së palestinezëve për jetë.

Pyetjes se çfarë e pret qytetarin evropian në një luftë të Ukrainës apo të Gazës, ku ndikimi ushtarak dhe politik është përpjesëtimisht më i madh, do t'i shtohet edhe një dimension shumë më i largët, ai i fërkimit mes Kinës dhe Tajvanit, që do të ishte drejtpërsëdrejti fërkim mes Kinës e SHBA.

Qytetarin evropian që mund të jetë i paiteruar për politikë mund t'i dalë e vlefshme informata se forcimi i Rusisë në Ukrainë do të ishte sinjal për të kërcënuar zonën e ardhshme, Baltikun. Apo, se zgjerimi i luftës në Lindjen e Mesme mund të sjellë një valë të re refugjatësh nga ajo pjesë e botës dhe një mllef të popullatës evropiane me prejardhje arabe a besim mysliman, që shikojnë çdo ditë se sa më e pavlerë është jeta e një fëmije a gruaje palestineze krahasuar me fëmijën dhe gruan e ndonjë kombi tjetër.

Dhe çfarëdo fërkimi ushtarak mes Kinës e Tajvanit do të rrezikonte dërgimin e gjysmëpërçuesve dhe elementeve të tjerë të teknologjisë që i prodhon Tajvani e që janë jetike për prodhimin industrial në Evropë.

3.

Si do të jenë evropianët më evropianë, apo a do të jenë evropianët më evropi-

anë, këto janë dy pyetje të vlefshme.

Pyetjet nuk janë të reja. Janë shtruar para gati gjysmë shekulli nga gjenerali De Gaulle në Francë (ndonëse në forma të tjera) dhe formulohen gjithnjë me një formulim të pashprehur hipotetik: si do t'ia bënte Evropa pa SHBA?

Kjo pyetje shtrohet në kohën kur njëkohësisht njihej se fuqia më e madhe evropiane është SHBA, duke i prirë aleancës së NATO-s dhe duke garantuar kështu prosperitetin e një Evrope demokratike që shemb në formë të paprecedent kufij të vet shtetërorë në favor të solidaritetit e të bashkimit politik dhe ekonomik.

Tash, kur shtrohet sërish, bëhet në momentin kur BE kalon nëpër ciklin e vet të ri të debatit për rirregullim, përfshirë edhe propozimet që ky rirregullim të japë më shumë vendimarrje të shumicës e më pak bllokime me përdorim vetoje.

Por, si çdo debat tjetër, zhvillohet gjithnjë me praninë kokëfortë të realitetëve që duke qenë aty janë të gatshme për test imediat të çfarëdo hipoteze në planifikim politikash. Ballkani Perëndimor është ajo prani kokëfortë realitetesh që do të qëndrojë si test imediat. Dhe kjo prani do të testojë - t'i marrim si kryesore - dy çështje thelbësore të politikave të evropianëve që duan të jenë evropianë. Një është se si të krijohet një ambient sigurie për Ballkanin

Perëndimor pa SHBA në kushtet kur në këtë rajon ekziston mundësia e qartë e identifikueshme e krijimit të një zone të veçantë që është kundërshtarë e bashkësisë euroatlantike. Dy, si të integrohet ky rajon në bashkësinë euroatlantike, kur një pjesë kritike e tij, e lidhur me nocionin e ringjalljes së çështjes kombëtare serbe, është qartësisht kundër bashkësisë euroatlantike?

Këto pyetje përmblidhen në një mospërputhje historike, kur duhet të bëhet integrimi i Ballkanit Perëndimor në bashkësinë euroatlantike, por një pjesë e këtij rajoni, që do t'iu kthehet luftërave të humbura të viteve nëntëdhjetë, pjesën “euro” të bashkësisë euroatlantike e sheh në formë bankomati që duhet të japë para, ndërsa pjesën “atlantike”, gjegjesisht NATO-n, nuk e sheh fare në atë dyzim.

4.

Evropianët që duan të jenë më shumë evropianë janë në një hall ciklik. Janë duke u marrë me Ukrainën, Gazën apo Tajvanin dhe me hipoteza se si do të dukej Perëndimi pa rolin e deritanishëm amerikan - një gjë që nuk është e re, pra është elaboruar që nga De Gaulle. Por, më 2024 duhet të kalojnë së pari testin në Ballkanin Perëndimor. Për dallim prej vajzës që shkoi për ta kryer gjimnazin në Amerikë, testi i maturës për Evropën politike kryhet në juglindje të kontinentit.

© Veton Surroi & KOHA

NGA PETRO KARANXHA

KRIZË IDENTITETI E FËMIJËVE TË EMIGRANTËVE SHQIPTARË

Për një të ardhme më të mirë shqiptarët kanë emigruar nga vendi i tyre në këto 30 vite të demokracisë, në vende të ndryshme të botës. Ky largim ka sjellë lindjen e një fenomeni që mund ta quajmë kriza e identitetit shqiptar, sepse pavarësisht pasurisë kulturore të prindërve të tyre, gjenerata e dytë po e humbet lidhjen me identitetin e origjinës.

Kjo humbje e identitetit po sjell një krizë jo vetëm personale për fëmijët, por edhe një krizë familjare. Shumë prindër madje, pyesin veten pse fëmijët nuk i kuptojnë ose nuk e njohin sakrificën që të gjithë emigrantët e gjeneratës së parë kanë bërë gjatë këtyre 30 viteve të emigracionit.

Le të kujtojmë për një moment cilat ishin valët e emigrantëve në Perëndim, sidomos në Amerikën e Veriut.

Vala e parë e emigrantëve shqiptarë pas ndryshimit të sistemit nisi në fillim të viteve 1990 dhe vendosi themelet për një komunitet që përjetoi sfida të shumta. Ky mund të quhet edhe grupi i emigrantëve eksplorues, sepse ata erdhën pa asnjë mbështetje apo njohuri mbi vendin e imigracionit. Pas disa flukseve, si ato të viteve 2000 dhe më pas 2010, si dhe këto 5 vitet e fundit, kur arsyet kanë ndryshuar, vërehet se emigracioni nuk është më eksplorues dhe po bëhet gjithnjë e më shumë jo vetëm për arsye ekonomike, por edhe për arsye sociale. Komuniteti ka përbërur ndryshime të mëdha, sikurse dhe shumë sfida. Nga ana tjetër, me kalimin e kohës, po shihet qartë se fëmijët e emigrantëve, pavarësisht nëse janë lindur në Perëndim apo kanë ardhur këtej në një moshë të vogël, ata po ballafaqohen me një realitet të vështirë: humbjen e identitetit shqiptar.

Para se të vazhdoj shtjellimin e kësaj teme, do doja të jap një përkufizim të identitetit kombëtar të individit. Me pak fjalë, identiteti kombëtar është një ndjenjë e përbashkët e përgjegjësisë, solidaritetit dhe lidhjes emocionale të një grupi njerëzish me një komb të caktuar. Ky identitet shprehet përmes gjuhës, kulturës, historisë dhe vlerave të përbashkëta, duke ndikuar në ndjenjën dhe ndërgjegjësimin për bashkim dhe mbrojtje të trashëgimisë kombëtare. Identiteti kombëtar ndikon edhe në formimin e personalitetit individual.

Ndërkohë, ndikimi i kulturës perëndimore po e lëkund identitetin që përkufizojmë më lart. Mospërputhja me normat tradicionale shqiptare apo dhe humbja e gjuhës shqipe kanë si pasojë krizën e identitetit tek brezi i dytë. Ky brez fëmijësh ndihet i ndarë midis dy botëve, me një këmbë në traditat e prindërve që nuk i kupton dhe këmbën tjetër në realitetin perëndimor, ku



egoja individualiste përkëthelet nga boshti pa vlera. Kjo kontradiktë ka filluar të shkaktojë një krizë personale dhe nxit pyetje identitare thelbësore. Shumë prindër pyesin veten pse i kanë bërë të gjitha këto sakrifica kur fëmijët nuk arrijnë të kuptojnë qëllimin e tyre, sepse sakrifica e prindërve është pjesë e traditës që lidhet me trashëgiminë, jo vetëm të familjes, por edhe të kombit.

Në qytete si New York apo Toronto, ku asimilimi dhe ndikimi i kulturës lokale është i theksuar, kjo problematikë bëhet akoma më e ndjeshme dhe fëmijët janë të detyruar të përballojnë një ngërç identitar, çka përbën një sfidë jo të lehtë për ta.

Përmes bisedave me disa prej tyre, të moshave të ndryshme, jam munduar të kuptoj se si e ndiejnë ata identitetin shqiptar. Përgjigjet ishin shumë të shkurtra, por edhe, fatkeqësisht, surprizuuese. Atë që unë perceptova do ta shpreh me një parabolë: identiteti shqiptar është si një kafshë e lirë në pyll, ndërsa identiteti në Perëndim është si një kafshë në kopshtin zoologjik ose edhe në ambientin shtëpiak.

Ky konflikt mes identitetit të kafazit dhe atij të pyllit po sjell edhe humbjen e identitetit familjar. Brezi i dytë

largohet nga trashëgimia kulturore, sepse ajo që është ndërtaur në shekuj i duket shumë e egër. Ky brez mund të afrohet me aspekte specifike kulturore si muzika, sporti, por jo me zakonin dhe ritet shqiptare. Rritja e tensionit mes brezave ka filluar të shkaktojë edhe një lloj krize në familje, për shkak të vështirësive të komunikimit të një pjese të prindërve në gjuhë të huaj apo vështirësive (apo mungesës) së të kuptuarit të shqipes nga fëmijët. Shpesh, prindërit ndihen të pasigurt në transmetimin e trashëgimisë së tyre tek fëmijët dhe kjo sfidë krijon tensione. Kjo më sjell ndërmend shprehjen e disa fëmijëve që thonë: “Unë kuptoj shqip, por nuk flas”. Ky “zhargon” është shumë i dëmshëm, sepse ata në të vërtetë kuptojnë disa fjalë, por jo mendimin që ato fjalë mund të transmetojnë.

Këto mendime po i shpreh për të tërhequr publikisht vëmendjen rreth këtij fenomeni por dhe për të sensibilizuar sadopak fëmijët dhe familjet mbi këtë disbalancë kulturore. Në këtë periudhë të ndjeshme, është e rëndësishme të adresohen krizat personale dhe familjare që shkaktohen nga humbja e identitetit. Komuniteti dhe familjet duhet të përqendrohen jo vetëm në nxitjen e bashkëbisedimit, por edhe në nxitjen e rikthimit të fëmijëve në rrugën e rilidhjes me

identitetin e tyre shqiptar. Është i nevojshëm një angazhim i fortë me përkrahje emocionale për t'i ndihmuar fëmijët të kuptojnë, pranojnë dhe vlerësojnë identitetin e tyre shqiptar në kontekstin e shoqërisë perëndimore. Nëse fëmijët nuk kuptojnë identitetin kombëtar shqiptar, ata nuk do kuptojnë prindërit e tyre dhe, si rrjedhojë, nuk do gjejnë as veten. Është shumë e vështirë të jesh shqiptar në kafaz.

Nuk është e lehtë të mbash një komunitet të bashkuar, sidomos kur ke të bësh me një komunitet që luftën kryesore e ka bërë për mbijetesë dhe përpjekjet për të siguruar familjen në një vend të huaj. Shumë nga fëmijët e ardhur ose lindur këtu nuk e kuptojnë thelbin dhe ndjenjën e përgjegjësisë që prindërit kanë pasur për t'u siguruar një të ardhme më të mirë. Nuk them që fëmijët duhet të mendojnë për këtë çdo ditë, por ata duhet ndjenjë këtë si një pjesë thelbësore të identitetit të tyre.

Një iniciativë për të organizuar një qendër kulturore që ofron çdo javë aktivitete për komunitetin shqiptar mund të jetë një hap i rëndësishëm. Një kafe apo një ngjarje sociale mund të jenë të mjaftueshme për t'u treguar fëmijëve “përrallat” e emigracionit. Këto aktivitete mund të shërbejnë si hapësira ku fëmijët mund të ndajnë

përvojat e tyre, të nxisin njëri-tjetrin dhe të formojnë lidhje të reja, duke krijuar kështu një atmosferë të mbështetjes dhe solidaritetit. Gjithashtu, organizimi i eventeve kulturore dhe edukative do të kontribuojnë në nxitjen e njohjes dhe ruajtjes së trashëgimisë shqiptare në mesin e brezave të rinj.

Në kërkim të identitetit të tyre, fëmijët e emigrantëve ballafaqohen me një sfidë të vërtetë personale dhe familjare, por duke përqendruar përpjekjet në ruajtjen e identitetit shqiptar, komuniteti dhe familjet mund të ndihmojnë në mbrojtjen e thelbit të trashëgimisë shqiptare në Perëndim. Kësisoj, çdo hap i ndërmarrë në këtë drejtim do të jetë një investim për brezat e ardhshëm të komunitetit.

Në mbyllje po kujtoj dy shprehje të vëllezërve Frashëri. Sami Frashëri ka thënë: “Dashuria për atdhenë lind nga dashuria për familjen”, ndërsa Naim Frashëri ka thënë: “Njeriu, po s’desi kombin e tij, Mëmëdhenë, nuk ka pjesë nga njerëzia, s’do as vetëhenë.”

Le t’ua ngulisim në mendje këto shprehje fëmijëve tanë, që të mos humbasin identitetin personal dhe bashkë me të edhe identitetin shqiptar!

(Pedagog në Sheridan College, Toronto)

KIM MEHMETI

Forca shtetbërëse e një populli nuk matet vetëm nëpërmjet nënshkruesve të deklaratës së pavarësisë, por mbi të gjitha me atë sa ai mund e di të ndërtojë shtet të së drejtës, pra shtet institucional ku ligji do vlejë njësoj edhe për të pushtetshmin e të pasurin edhe për të pambrojturin dhe skamnorin.

Vlerësuar nga ky këndvështrim, Shqipëria nuk ishte mjaftueshëm shtet as në kohën e Partisë së Punës kur ekzistonte thujse vetëm sa të kishte Enveri ku ta burgoste popullin e vet si dhe ku të vriste e dhunonte kënd të donte. Edhe atë jo vetëm pse nuk kishte ligj mbi vullnetin e tij, por pse elitat e shqiptarisë – njësoj si sot gjatë regjimit të Piktorit - e mbanin kokën te prapanica dhe shtireshin se nuk e dëgjojnë piskamën e fatkeqve.

Shqipëria nuk ia doli të konsolidohet si shtet institucionalë dhe i së drejtës as tri dekada pas rënies së komunizmit, duke mbetur kështu atë që ishte edhe në kohën e Enverit: shtet që i takon partisë, me popullin në të që i shërben sunduesit.

Dhe duke qenë shoqëri e cila nuk pati guxim të përballet me të shkuarën e vet komuniste, Shqipëria shumë shpejtë ra në duart e pasardhësve të 'xhelatëve' që e mbajtën gjallë regjimin më antishqiptarë – atë të Enverit. Ndërkohë, të huajt, mbase edhe gabimisht, nisën të besojnë se Shqipëria nuk ka potencial të mjaftueshëm shtetformues, andaj duhej atë bërë 'protektorat', por të një lloji krejt tjetër.

Duke e ditur se shtetin e drejton ai që i kontrollon 'peshoret' e gjyqësorit, të huajt vendosën që mëmëdheut tonë t'ia reformonin drejtësinë dhe kështu atë ta 'pushtonin' nëpërmjet SPAK-ut.

SHQIPËRINË E 'SUNDOJNË' ATA QË AS I KA ZGJEDHUR E AS I KA VOTUARA NJERI – 'SPAKISTANIANËT'?!



Dhe më në fund Shqipëria u bë 'Spakistanë' me në krye Piktorin, pra u bë shtet ku askush nuk e dinë nëse prokurorët dhe gjykatësit mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre dhe nëse kryehajdutët e 'Rilindjes' e kontrollojnë SPAK-un, apo SPAK-u i kontrollon ata.

Por ku megjithatë shihet qartë se 'SPAKistianianëve' u është dhënë urdhër të mos merren gjithaq me bërjen e Shqipërisë shtet të së drejtës, por me pastrimin e saj nga 'plehu' politikë i tridhjetë viteve të fundit edhe atë,

duke i mbyllur sytë përpara 'aleancës së qelbësirave', duke i lënë pra të qetë kryehajdutët e 'Rilindjes', ata që Shqipërisë ia harxhuan të ardhmen duke e bërë të pabanueshme për brezin e ardhmërisë.

Dhe mbase Shqipëria edhe nuk mund të arrinte më larg se aty ku ndodhet sot me ne të cilët - si edhe gjatë dekadave enveriste – u mbetëm besnikë partive dhe pushtetarëve, por jo edhe shtetit e popullit, me ne që dëshmuam sa nuk e kemi kuptuar se demokracia është përrallë e bukur për t'i vënë në

gjumë fëmijët nëse ajo shërben për t'u pasuruar pushtetarët për të cilët nuk vlen gjë ligji.

Me ne pra që tri dekada me radhë shtireshim se nuk e dinim që aty ku askush nuk mbanë përgjegjësi për keqeverisjen dhe ku nuk ka moral, nuk të vlen gjë ligji dhe vota, se demokraci është edhe kur dy budallenjtë e mbivotojnë një të mençur, por jo edhe kur një votues 'kushton' më lirë se një dele.

Dhe duke qenë se thujse të gjitha ua lamë në duar hajdutokratëve, të cilët ditën na zhatnin e natën e rrënonin Teatrin Kombëtarë dhe mbëmendjen kolektive për të shkuarën e shqiptarisë, ne edhe jemi bashkëfajtorë pse mëmëdheun tonë sot e 'sundojnë' ata që as i ka zgjedhur, e as i ka votuara njeri – 'SPAKistianianët'?!

Pra të gjithë ne jemi fajtorë pse edhe sot, njësoj si në kohën e Enverit, shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë ndjeheni si popull pa mëmëdhe!

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Temperature
- Pulse
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google



- Business Cards
- Logos
- Posters
- Banners
- Flyers
- Video Marketing
- Online Marketing

LONDON

Për çdo konsultim mund te vini në
zyrat tona

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road,
London E13 8HT